Republika e Maqedonisë së Veriut
Enti shtetëror i statistikës

MAKSTAT

METODOLOGJIA

PËR PËRGATITJEN, ORGANIZIMIN DHE REALIZIMIN E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2021

Shkurt, 2021

PARATHËNIE

Në bazë të nenit 17, paragrafi 2 i Ligjit për Regjistrim të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.19/21), dhe me qëllim sigurimi të parimeve të njëllojta për organizimin e regjistrimit dhe aplikimin e njëllojtë të bazave metodologjike në regjistrim, drejtori i Entit shtetëror të statistikës sjellë Metodologjinë për përgatitjen, organizimin dhe zbatimin e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021 (në tekstin e mëtutjeshëm: Regjistrimin)

Metodologjia është e dedikuar, fillimisht, për të gjithë pjesëmarrësit në Regjistrim, të përcaktuar me Ligjin për Regjistrim, por edhe për të gjithë shfrytëzuesit e rezultateve që dalin nga Regjistrimi. Ajo përmban të gjitha sqarimet e nevojshme metodologjike, organizative dhe teknike, me qëllim sigurimi i aplikimit të njëllojtë të qasjes së re të kombinuar metodologjike dhe teknologjinë e re për realizimin e Regjistrimit.

Të gjithë pjesëmarrësit janë të obliguar që vazhdimisht t'i përmbahen dhe ta zbatojnë këtë Metodologji gjatë kryerjes së detyrave të cilët u janë besuar për realizim të Regjistrimit, me qëllim sigurimin e parimeve të njëllojta për organizimin dhe zbatimin e Metodologjisë në realizimin e Regjistrimit, për të fituar të dhëna cilësore statistikore.

Shkup, 2021

Drejtor
Apostol Simovski

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 3
PËRMBAJTJA 4
I. HYRJE 5
1. DEFINIMI I NOCIONIT REGJISTRIM I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE 5
3. ZBATIMI I TË DHËNAVE NGA REGJISTRIMI I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE 6
4. BAZA LIGJORE 6
II. PJESA E PËRGJITHSHME 7
1. OBJEKTIVAT, KARAKTERISTIKAT KRYESORE DHE PARIMET E REGJISTRIMIT 8
2. NJËSITË QË DO REGJISTROHEN 9
3. NJËSITË QË NUK REGJISTROHEN 10
4. DEFINICIONE DHE NOCIONE TË CAKTUARA QË PËRDOREN NË REGJISTRIMIN DHE DOMETHËNIA E TYRE: 11
5. KATEGORITË E POPULLSISË PËR TË CILËT DO TË SIGUROHEN TË DHËNA PËR REGJISTRIM 12
6. MOMENTI KRITIK I REGJISTRIMIT 13
7. KOHA (PERIUDHA) E REGJISTRIMIT 13
8. REGJISTRIMI I KATEGORIVE TË VEÇANTË TË PERSONAVE 13
9. VENDI I REGJISTRIMIT 14
10. METODA E REGJISTRIMIT 16
11. PJESËMARRËSIT NË REALIZIMIN E REGJISTRIMIT 19
12. PËRDORIMI I GJUHËVE NË REGJISTRIM 21
13. FUSHATA INFORMUESE DHE PLANI KOMUNIKUES PËR REGJISTRIMIN 21
14. MBROJTJA E TË DHËNAVE NGA REGJISTRIMI 21
15. PËRPUNIMI DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE NGA REGJISTRIMI 22
III. TEKNOLOGJIA REGJISTRUESE 22
IV. TIPARET PËR POPULLSINË QË REGJISTROHET 23
1. KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE 23
2. KARAKTERISTIKA DEMOGRAFIKE 24
3. KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE 25
4. KARAKTERISTIKAT ARSIMORE 27
5. MIGRIMI 28
6. KARAKTERISTIKAT ETNOKULTURORE 30
7. INVALIDITETI 31
8. KARAKTERISTIKAT E EKONOMIVE FAMILJARE DHE FAMILJEVE 32
9. BUJQËSIA 35
10. VENDQËNDRIMI, BANESAT DHE KUSHTET PËR BANIM 36
V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE 44

Në bazë të nenit 17, paragrafi 2 i Ligjit për Regjistrim të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.19/21), dhe Mendimit të Këshillit për statistikë nr. 02-2/7 nga 04.02.2021, dhe me qëllim sigurimin e parimeve të njëllojta dhe aplikimin e njëllojtë të Metodologjisë gjatë Regjistrimit, drejtori i Entit shtetërore të statistikës sjellë:

METODOLOGJIA

për përgatitjen, organizimin dhe realizimin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, viti 2021

I. HYRJE

1. DEFINIMI I NOCIONIT REGJISTRIM I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave definohet si operacion statistikor, me të cilën në intervale të rregullta kohore (më shpesh në 10 vite) realizohet numërimi i popullsisë në territorin e vendit, nga njësitë më të vogla gjeografike deri në nivel shteti, së bashku me definimin e karakteristikave demografike, sociale dhe ekonomike të popullsisë së përgjithshme. Përkufizimi i dytë më i përdorur është se Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave paraqet proces të mbledhjes, përpunimit, vlerësimit, analizës dhe diseminimit të të dhënave për popullsinë, ekonomitë familjare dhe banesave në një shtet (ose në territor të definuar saktë) në interval të rregullt kohor.

Është e zakonshme që regjistrimet të realizohen në çdo 10 vjet, edhe atë në vitet që përfundojnë në zero ose një.

Regjistrimet bashkëkohore janë burim i rëndësishëm statistikor për mbledhjen e të dhënave individuale për popullsinë, ekonomitë familjare dhe banesave nga njësitë më të vogla gjeografike deri në nivel shteti, dhe në këtë mënyrë:

- paraqet bazë të rëndësishme për vendimmarrje dhe menaxhim bashkëkohor në të gjitha nivelet;
- sigurojnë një fond të madh të të dhënave statistikore relevante të nevojshme për analiza shkencoro-profesionale të situatës dhe planikifikim të ardhshëm makroekonomik në zhvillimin e vendit;
- sigurojnë vazhdimësi dhe krahasueshmëri me rezultatet nga regjistrimet e mëhershme;
- paraqet trashëgimi e cila duhet tu sigurohet brezave të sotit dhe të ardhshëm.

Vendet anëtare të OKB-së janë të obliguara të realizojnë Regjistrimin e popullsisë dhe banesave, në përputhje me rekomandimet e sjellura ndërkombëtare për regjistrimin e popullsisë dhe banesave, të përgatitur nga ana e Komisionit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe Eurostatit gjatë vitit 2020 (Conference of European Statisticians Recommendation for the 2020 Censuses of Population and Housing – CES, 2016).

2. OBJEKTIVAT KRYESORE TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE

Objektivat kryesore të rekomandimeve ndërkombëtare për regjistrimet e popullsisë dhe banesave rreth vitit 2020, (të përgatitura në mënyrë të përbashkët nga ana e Komisionit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe institucionin statistikor të Bashkimit Evropian), janë:

- të sigurojë udhëzime metodologjike dhe mbështetje të shteteve në planifikimin dhe realizimin e regjistrimeve të popullsisë;
- të lehtësohet dhe përmirësohet krahasueshmëria e të dhënave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar nëpërmjet selektimit të tipareve kryesore dhe nëpërmjet harmonizimit të definicioneve dhe klasifikimeve.

Për shkak të seriozitetit dhe vëllimit, Regjistrimi kërkon kujdes të jashtëzakonshëm në planifikim, përgatitje, testim, analizë dhe dokumentim të çdo faze të saj. Prandaj, sipas rëndësisë së tij të përgjithshme, Regjistrimi renditet si një ndër aktivitetet me interes të lartë shtetëror, ndërsa zbatimi i tij rregullohet gjithmonë me një Ligj të veçantë për Regjistrim, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për realizimin e Regjistrimit nevoitet analizë e gjithanshme dhe thelbësore, informim, kushte të krijuara, por edhe mbështetje adekuate dhe përfshirje të institucioneve të shtetit në nivel më të lartë.

3. ZBATIMI I TË DHËNAVE NGA REGJISTRIMI I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE

Rezultatet e agreguara statistikore, të fituar nga të dhënat e mbledhura me regjistrim, përveç për qëllime statistikore, shfrytëzohen edhe për planifikime makroekonomike, për analiza shkencore dhe për hulumtime të tjera.

Me regjistrimin sigurohen të dhëna të cilat bashkë me të dhënat e regjistrimeve paraprake janë me rëndësi të madhe edhe për statistikën, rrespektivisht japin bazë solide për krijimin e serive kohore me analizën e të cilave mundësohet shqyrtimi dhe vlerësimi cilësor i faktorëve të zhvillimit demografik, zhvillimit të lëvizjeve sociale, zhvillimit urban dhe të ngjajshme, në të kaluarën, të tashmen dhe në të ardhmën.

Me Regjistrimin e popullsisë sigurohen të dhëna për numrin e popullsisë, për shpërndarjen territoriale, si dhe për strukturën e saj sipas tipareve demografike, gjeografike, ekonomike dhe sociale.

Me Regjistrimin e popullsisë sigurohen të dhëna për numrin e ekonomive familjare dhe për shpërndarjen e tyre territoriale, si dhe të dhënat për strukturën e ekonomive familjare sipas madhësisë, llojit dhe përbërjes familjare.

Me Regjistrimin e vendqëndrimeve sigurohen të dhëna për numrin e vendqëndrimeve sipas llojit dhe shpërndarjes territoriale, ndërsa për banesat, në kuptimin e saj ndërtimor, sigurohen të dhëna për madhësinë dhe pajisjen me instalime dhe hapësira ndihmëse.

Të dhënat nga regjistrimi mund të shfrytëzohen edhe për krijimin dhe udhëheqjen e regjistrave statistikor në kompetencë të Entit shtetëror të statistikës.

4. BAZA LIGJORE

Korniza juridike për realizimin e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2021 është e definuar në:

<u>Rregullativa ndërkombëtare</u>

- Rekomandimet ndërkombëtare për regjistrimet e popullsisë dhe banimit rreth vitit 2020, të përgatitura nga ana e Komisionit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe Eurostatit (Conference of European Statisticians Recommendation for the 2020 Censuses of Population and Housing – CES, 2016)
- Rregullativa e BE-së 763/2008 e Parlamentit dhe Këshillit, si rregullativ themelore (fillestar) për statistikën evropiane lidhur me regjistrimet e popullsisë dhe banimit;

- Rregullativa e BE-së 543/2017 e Parlamentit dhe Këshillit për përcaktimin e rregullave për zbatimin dhe specifikimin teknik të tipareve dhe analizën e tyre për statistikën evropiane për Regjistrimin e popullsisë dhe banimit, 2021;
- Rregullativa e BE-së 712/2017 e Parlamentit dhe Këshillit – për përcaktimin e vitit referues dhe programin për meta të dhënat për statistikën evropiane nga Regjistrimi i popullsisë dhe banimit, 2021;
- Rregullativa e BE-së 881/2017 e Parlamentit dhe Këshillit – për strukturën e raportit për cilësi dhe formatit teknik për dorëzimin e të dhënave të regjistrimit për statistikën evropiane nga Regjistrimi i popullsisë dhe banimit, 2021;
- Rregullativa e BE-së 1799/2018 e Parlamentit dhe Këshillit për desiminimin e tipareve të përzgjedhura në 1km² për statistikën evropiane nga Regjistrimi i popullsisë dhe banimit, 2021.

Rregullativa vendore

- Ligji për statistikë shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 54/1997, 21/2007, 51/2011, 104/2013 , 42/2014, 192/2015, 27/16, 83/18, 220/18, 31/20)
- Ligji për Regjistrimit e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2021 („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 19/21)
- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.7/2005, 103/2008, 124/2008, 124/2010,135/2011, 43/2014, 153/2015, 99/2016 dhe 64/2018 dhe 42/2020).

II. PJESA E PËRGJITHSHME

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pas Luftës së Dytë Botërore, janë realizuar 8 regjistrime të popullsisë, edhe atë: në vitin 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991, 1994 dhe në vitin 2002, si dhe Regjistrimi i parealizuar, përkatësisht Regjistrimi i ndërprerë i vitit 2011. Të gjithë regjistrimet janë realizuar me zbatimin e mënyrës tradicionale të regjistrimit, me anë të intervistës nga ana e regjistruesve të trajnuar, nëpër formular regjistrues.

Në serinë e regjistrimeve të realizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, secili regjistrim i popullsisë që pason është më kompleks në përmbajtjen e tij sesa ai i mëparshmi. Kërkesat i drejtohen veçanarisht Entit shtetërore të statistikës, si koordinatori kombëtar i sistemit statistikor të vendit dhe institucioni kryesor kombëtar dhe përgjegjës për realizimin e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Për Entin shtetëror të statistikës, si koordinator kombëtar i sistemit statistikor në vend, një nga prioritetet strategjike është përgatitja, organizimi dhe zbatimi në kohë dhe në mënyrë efikase e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2021.

Mungesa e të dhënave të regjistrimit me një datë më të re, për shkak të faktit se Regjistrimi në vitin 2011 ishte ndërprerë dhe nuk ishte realizuar, me kalimin e çdo viti ka ndikim të drejtpërdrejtë në prodhimin e të dhënave statistikore.

Në vazhdën e përgatitjeve të Regjistrimit 2021, Enti shtetëror i statistikës zhvilloi një regjistrim testues të popullsisë në periudhë prej 14 deri më 30 qershor të vitit 2019 dhe realizon një Pilot-regjistrim në periudhë prej 11 deri më 21 janar të vitit 2020.

1. OBJEKTIVAT, KARAKTERISTIKAT KRYESORE DHE PARIMET E REGJISTRIMIT

1.1. OBJEKTIVAT E REGJISTRIMIT:

Regjistrimi paraqet burim primar për sigurimin e të dhënave demografike, gjeografike, arsimore dhe socio - ekonomike për popullsinë e një shteti.

Me Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2021, do të sigurohen të dhëna për:

- numrin e përgjithshëm dhe për shpërndarjen territoriale të njësive kryesore të Regjistrimit (personave, ekonomive familjare dhe banesave),
- karakteristikat të njësive kryesore të Regjistrimit (persona, ekonomi familjare dhe banesa) me tiparet e tyre dhe
- përcaktimi i ndryshimeve që kanë ndodhur në periudhën prej realizimit të fundit të Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2002.

Sipas kësaj, qëllimi kryesor i Regjistrimit është të përcaktohet numri i popullsisë dhe rradhitja e saj territoriale, të sigurohen të dhëna për tiparet vitale, arsimore, ekonomike, etnike, tiparet migruese të popullsisë dhe të tjera. Regjistrimi është bazë për vlerësimin e numrit dhe të lëvizjes së popullsisë në periudhën ndërmjet regjistrimeve, si edhe për projektime afatgjata të numrit të popullsisë në të ardhmen.

Meqenëse, përveç regjistrimit të popullsisë, njëkohësisht do të realizohet edhe regjistrimi i ekonomive familjare, Regjistrimi ka për qëllim sigurimin e të dhënave edhe për ekonomi familjare dhe familje jo vetëm si bashkësi ekonomike kryesore (strukturës së tyre sipas numrit të anëtarëve, numrit të personave aktiv, përkatësisht personave të mbajtur, burimin e të hyrave), por edhe si bashkësi biologjike si edhe ndryshimin në numrin dhe strukturën e familjeve dhe karakteristikat dhe tiparet e tyre kryesore.

Qëllimi i Regjistrimit të banesave është të sigurohen të dhëna për strukturën e fondit banesor, domethënë të përcaktohet numri i banesave dhe të sigurohen të dhëna për shfrytëzimin e tyre, sipërfaqen, numrin e dhomave, pajisjen me hapësira ndihmëse (kuzhinë, hapësira sanitare), pajisjen me instalime elektrike, ujësjellës dhe ngrohje qendrore, mandej viti i ndërtimit të tyre, katet etj. Nga Regjistrimi duhet të sigurohen edhe të dhëna për banesat e pabanuara, si edhe për banesat që përdoren për pushim dhe rekreim (shtëpi vikendi dhe shtëpi familjare).

Me Regjistrimin 2021 do të grumbullohen të dhëna edhe për personat që gjenden jashtë vendit mbi 1 vjet, me qëllim që të sigurohen të dhëna më relevante edhe për numrin e personave të shpërngulur nga vendi.

Gjithashtu, me Regjistrimin e vitit 2021 do të grumbullohen edhe të dhëna për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të personave - njësi të regjistrimit. Qëllimi i përfshirjes së këtij grupi të pyetjeve është që nga Regjistrimi të sigurohen të dhëna për numrin e personave që për shkak të gjendjes së tyre të përgjithshme shëndetësore kanë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, sipas llojit dhe shpërndarjes së tyre territoriale, dhe të cilat në të ardhmen do të shërbejnë si kornizë statistikore për hulumtime ekzemplare për personat me llojin e këtillë të vështirësive.

Domethënë, prej Regjistrimit sigurohen të dhëna statistikore të plota, cilësore, të azhurnuara dhe ndërkombëtarisht të krahasueshme për popullsinë, ekonominë familjare dhe banesave, për të përmbushur nevojat kombëtare dhe ndërkombëtare të përdoruesve.

1.2. KARAKTERISTIKAT DHE PARIMET KRYESORE TË REGJISTRIMIT:

- **Numërimi individual** nënkupton të regjistrohen në mënyrë individuale të gjitha njësitë regjistruese, të definuara si lëndë e Regjistrimit, rrespektivisht për të gjithë ato do të grumbullohen të dhëna sipas të gjitha tipareve, të definuara si përmbajtje e Regjistrimit;
- **Universaliteti në suazat e shtetit,** rrespektivisht, Regjistrimi përfshin tërë territorin e shtetit dhe të gjitha njësitë e regjistrimit – personat (që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e shtetit), ekonomitë familjare dhe banesat;
- **Njëkohshmëria,** rrespektivisht regjistrimi i të gjitha njësive regjistruese në periudhë të njëjtë, të definuara saktë, ndërsa të dhënat kanë të bëjnë me definimin e momentit kritik të njejtë (me përjashtim të regjistrimit paraprak që realizohet para Regjistrimit të rregullt);
- **Periudhë e definuar,** rrespektivisht, regjistrimet realizohen në intervale kohore të definuara saktë. Në përputhje me rekomandimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, regjistrimet realizohen me periudhë dhjetëvjeçare, në vitet që mbarojnë me 0, me çka mundësohet edhe krahasimi i të dhënave në nivel ndërkombëtar;
- **Të dhënat e zonave të vogla gjeografike –** Regjistrimi mundëson të sigurohen të dhëna për njësitë e Regjistrimit në zona më të vogla gjeografike, madje edhe në rreth regjistrues (njësia më e vogël territoriale statistikore për nevojat e Regjistrimit), por në të njëjtën kohë duke u kujdesur në mënyrë rigoroze për mbrojtjen e të dhënave individuale.
- Regjistrimi bazohet mbi **metodologjinë e njëllojtë**, domethënë mbi definicionet dhe klasifikimet e njëllojta të njësive dhe tipareve të tyre, si edhe mbi përpunimin programor të njëllojtë të të dhënave dhe publikimin e rezultateve;
- **Mbrojtja e të dhënave,** rrespektivisht, obligim ligjor i të gjithë pjesëmarrësve në Regjistrim është të kujdesen për fshehtësinë dhe konficidialitetin e të dhënave të grumbulluara në përputhje me zgjidhjet ligjore në fuqi;

Racionalizmi në të gjitha fazat e Regjistrimit, prej përgatitjeve deri në publikimin e rezultateve, në drejtim të arritjes së cilësisë së të dhënave me angazhim optimal të pjesëmarrësve dhe mjeteve.

2. NJËSITË QË DO REGJISTROHEN

Me Regjistrimin përfshihen njësitë në vijim:

1. Persona

Me Regjistrimin përfshihen:

- personat që kanë vendbanim apo vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pa marrë parasysh se në momentin e Regjistrimit gjenden në vend apo jashtë tij;
- shtetas të huaj të cilët janë të pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut me lejeqëndrim;
- personat e huaj me kërkesë të parashtruar për njohjen e të drejtës së azilit, të drejtën e pranuar të azilit, për shkak të mbrojtjes subsidiare dhe me status të pranuar të refugjatit, si dhe
- persona pa shtetësi të cilët në momentin e realizimit të Regjistrimit do të gjenden në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2. Ekonomia familjare

Me Regjistrimin do të përfshihen të gjitha ekonomitë familjare (në përputhje me përkufizimin për ekonomi familjare) të personave - njësi të Regjistrimit.

Me Regjistrimin do të përfshihen edhe ekonomitë familjare kolektive (të përbëra nga personat që jetojnë në institucionet për kujdesje të përhershme të fëmijëve dhe të rriturve, në manastire, dhe të ngjajshëm).

3. Banesa

Me regjistrimin do të përfshihen të gjitha banesat në vend, të dedikuara për jetesë, pa marrë parasysh nëse shfrytëzohen për jetesë të përhershme ose të kohëpaskohshme (për pushim, rekreim, punë sezonale) ose janë banesa të pabanuara.

Me regjistrimin përfshihen edhe hapësira apo objekte tjera të cilat nuk janë banesa në kuptimin e definicionit për banesë, por gjatë Regjistrimit shfrytëzohen për jetesë (hapësira tjera banimi, hapësirë afariste e banuar, vendqëndrim i improvizuar dhe vendqëndrim kolektiv);

Me Regjistrimin përfshihen edhe banesat kolektive (shtëpi dhe hotele për persona të vetëm, shtëpitë e pleqve, shtëpi studentore, konaqe të manastireve dhe të ngjajshme).

3. NJËSITË QË NUK REGJISTROHEN

Me Regjistrimin nuk do të përfshihen:

1. **Persona**

- personeli diplomatik i përfaqësive të huaja diplomatiko – konzulare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si edhe anëtarët e familjeve të tyre;
- personeli i huaj ushtarak dhe anëtarët e familjeve të tyre, të akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si edhe anëtarët dhe përfaqësuesit e organizatave dhe bashkësive ndërkombëtare që në momentin e Regjistrimit qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- shtetasit e huaj që në kohën e Regjistrimit gjenden në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për udhëtim zyrtar, vizitë private, pushim vjetor, mjekim, ekskurzion, udhëtime turistike dhe të ngjajshme.
- shtetasit e huaj që për shkak të punës ose shkollimit e kalojnë kufirin në bazë ditore.

2. Banesa

- banesat e përfaqësuesve diplomatiko – konzulare në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe banesat në pronësi të shteteve të tjera;

- banesat e pabanuara (të zbrazëta), që janë braktisur për shkak të rrënimit të tyre;

- banesat e zbrazëta në ndërtesat në të cilat ende nuk është lejuar vendosja;

- objekte të cilat në tërësi shfrytëzohen për vendosjen e veglave dhe mjeteve bujqësore, prodhimeve bujqësore, dru për ngrohje dhe të ngjajshme, ose shfrytëzohen për përpunimin e prodhimeve bujqësore.

-banesa kolektive në të cilat nuk jeton asnjë ekonomi familjare individuale (shtëpi dhe hotele për persona të vetëm, shtëpi pleqësh, shtëpia studentore, manastire, konaqe dhe të ngjajshme.)

4. DEFINICIONE DHE NOCIONE TË CAKTUARA QË PËRDOREN NË REGJISTRIMIN DHE DOMETHËNIA E TYRE:

. **"Vendbanim i zakonshëm",** është vendi gjeografik ku personi që regjistrohet jeton zakonisht, mund të jetë i njëjtë ose i ndryshëm nga vendi ku personi faktikisht gjendet në kohën e Regjistrimit ose mund të jetë vendi zyrtar (legal) i tij i banimit. Vendbanim i zakonshëm konsiderohet vendi ku personi e kalon pjesën më të madhe të pushimit të tij ditor përkatësisht të natës.

"Vendbanim zyrtar (legal) në Republikën e Maqedonisë së Veriut" është vendi në të cilin personi është i regjistruar në organ – ministri kompetent/e, në pajtueshmëri me rregulloren e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

"Ekonomi familjare" është çdo bashkësi familjare ose bashkësi tjetër e personave që deklarojnë se jetojnë së bashku dhe së bashku i shpenzojnë të hyrat e tyre për përmbushjen e nevojave themelore për jetë (banim, ushqim dhe tjetër), pa dallim nëse të gjithë anëtarët vazhdimisht gjenden në vendin ku është vendosur ekonomia familjare apo disa prej tyre qëndrojnë një kohë të caktuar në vendbanim tjetër, përkatësisht shtet të huaj (më pak se 12 muaj), për arsye pune, udhëtimi zyrtar, mjekimi ose për arsye tjera. Anëtarë të ekonomive familjare nuk do të konsiderohen të gjithë ato, mungesa e të cilëve është më e gjatë se 12 muaj.

"Ekonomi familjare me një anëtar" është ekonomia familjare e çdo personi që në vendin e Regjistrimit jeton vetëm dhe i cili nuk ka ekonomi familjare në vend tjetër. Personi i cili posedon ekonomi familjare me një anëtar, mund të jetojë në banesë të veçantë ose të ndarë apo si person i vetëm – qiraxhi ose në hotel për persona të vetëm dhe të ngjajshme, por kjo, pa marrë parasysh nëse jeton në dhomë të njëjtë me person tjetër të vetëm ose me anëtarë të ekonomisë familjare - qiradhënës, në mënyrë të pavarur i shpenzon të ardhurat e veta.

"Ekonomi familjare kolektive" është ekonomia familjare e përbërë nga personat që jetojnë në institucionet për kujdes të përhershëm të fëmijëve dhe të rriturve, në manastire dhe në spitale për vendosjen e të sëmurëve të pashërueshëm.

"Familja" është e definuar si bashkësi e dy ose më shumë personave të cilët jetojnë në të njejtën ekonomi familjare dhe të cilët janë të lidhur nëpërmjet martesës, lloj tjetër të regjistrimit ose bashkësi të kontraktuar (dmth. të pakurorëzuar) partnerë ose si bashkësi i prindit me fëmijë.

"Banesa" është tërësia e lidhur ndërtimore e dedikuar për jetesë, pa marrë parasysh nëse banesa në momentin e Regjistrimit shfrytëzohet vetëm për jetesë, për jetesë dhe për kryerjen e veprimtarisë, vetëm për kryerjen e veprimtarisë, për pushim dhe rekreim ose bëhet fjalë për banesë të pabanuar, por të rregulluar në aspekt ndërtimor.

Banesa përbëhet prej një ose më shumë dhomave, me ose pa hapësira ndihmëse (kuzhinë, qilar, paradhomë, banjë, tualet dhe të ngjajshme) dhe duhet të ketë qasje të veçantë nga rruga ose drejtpërdrejt nëpërmjet oborrit, terrenit ose nëpërmjet lokalit të përbashkët të ndërtesës, (shkallë, pasazh, galeri etj.), ndërsa mund të ketë një ose më tepër hyrje.

"Hapësirë tjetër e banuar" është hapësira apo objekti i banimit, që nuk është i dedikuar për banim dhe nuk paraqet banesë sipas kuptimit të definicionit për banesë, por gjatë kohës së Regjistrimit shfrytëzohet për jetesë.

"Rajon i regjistrimit" është pjesë e territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përcaktuar për organizimin dhe realizimin e Regjistrimit, e përbërë nga një ose më tepër komuna në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 13 të Ligjit për Regjistrim.

"Rreth i regjistrimit" është pjesë e territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut i formuar për nevojat e Regjistrimit dhe më shpesh përfshinë prej 50 deri në 100 ekonomi familjare, sipas kritereve të përcaktuara në "Udhëzimin për auditimin e kufijve të njësive hapësinore për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2021",

"Vetëregjistrim i personave shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët në periudhën e realizimit të Regjistrimit jetojnë/qëndrojnë jashtë vendit" Regjistrimi i kësaj kategorie të personave është

me anë të vetëregjistrimit nëpërmjet aplikacionit online e cila është në dispozicion në webfaqen e ESHS-së.

5. KATEGORITË E POPULLSISË PËR TË CILËT DO TË SIGUROHEN TË DHËNA PËR REGJISTRIM

1. „Popullsia e përgjithshme rezidente“ e përbëjnë personat - njësi të Regjistrimit, edhe atë:

- Personat-shtetas me vendbanim të zakonshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht se në momentin e Regjistrimit gjenden në vendin e banimit ose në vend tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Personat-të huaj të cilët qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut më gjatë se 12 muaj (një vit), me lejeqëndrimi të përhershme ose të përkohshme;
- Personat që kanë një vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe janë shtetas të saj, dhe në kohën e Regjistrimit qëndrojnë jashtë vendit për më pak se 12 muaj (një vit) për shkak të punës ose arsyeve të tjera, si dhe anëtarët e ekonomive familjare të tyre që qëndrojnë me ta;
- Personat që kanë vendbanim të zakonshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por të cilët gjatë kohës së Regjistrimit janë me punë në përfaqësi diplomatiko-konzulare të Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit, Kombet e Bashkuara dhe organizatat e saja, përfaqësi ose përfaqësues të komorave ekonomike jashtë vendit, njësi afariste jashtë vendit, përfaqësues ushtarak të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit dhe qytetarë që janë të angazhuar në bazë të një bashkëpunimi ndërkombëtarë, teknik apo lloj bashkëpunimi tjetër, si dhe anëtarët e ekonomive familjare që qëndrojnë përkohësisht jashtë vendit me personat e përmendur (pavarësisht nga kohëzgjatja e qëndrimit jashtë vendit për ndonjë nga arsyet e përmendura).

Përveç këtyre personave, te **Popullsia e përgjithshme rezidente** konsiderohen edhe personat në vijim nëse në vazhdimësi, në 12 muajt e fundit, janë të pranishëm në vend:

- Të huajt me status të pranuar të refugjatit të cilët gjenden në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë kohës së Regjistrimit;
- Të huajt me status të pranuar të azilantit për shkak mbrojtjes subsidiare, të cilët gjenden në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë kohës së Regjistrimit;
- Të huajt me kërkesë të parashtruar për pranimin e të drejtës për azil të cilët gjenden në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë kohës së Regjistrimit;
- Persona tjerë të cilët gjenden në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë kohës së Regjistrimit, (por të cilët i plotësojnë kriteret e mëparshme të definuara).

2. “Popullsia e përgjithshme jorezidente” e përbëjnë personat – njësi e Regjistrimit, edhe atë:

- Persona shtetas të Republikës së Maqedonisë, të cilët gjatë kohës së Regjistrimit qëndrojnë jashtë vendit më shumë se 12 muaj (një vit) për shkak të punës ose arsye tjetër, si dhe anëtarët e ekonomive familjare të tyre të cilët qëndrojnë me to;
- Persona-të huaj të cilët qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut deri 12 muaj (më pak se një vit), me lejeqëndrim të përkohshëm.

3. Popullsia e përgjithshme rezidente dhe jorezidente e përbëjnë kategorinë “**Popullsia e përgjithshme e regjistruar**”.

6. MOMENTI KRITIK I REGJISTRIMIT

Të dhënat duhet të shënohen në formularët regjistrues sipas gjendjes në 31 mars të vitit 2021 në ora 00:00, përkatësisht në mesnatë ndërmjet datave 31 mars dhe 1 prill të vitit 2021. Ky hark kohor në statistikë quhet si "momenti kritik i regjistrimit".

Regjistrimi bëhet sipas gjendjes në momentin që është definuar si moment kritik i regjistrimit. Të gjitha ndryshimet që ndodhin pas momentit kritik nuk merren parasysh. Domethënë, DUHET të regjistrohen të gjithë personat që kanë qenë të gjallë në momentin kritik të regjistrimit.
Për shembull:

NUK DUHET të regjistrohen:

a) Fëmijët e lindur pas momentit kritik (31 mars të vitit 2021, në ora 00:00), përkatësisht në periudhën prej 01 prill të vitit 2021, deri në ardhjen e regjistruesit në ekonomi familjare.
b) Nëse një person ka ndrruar jetë përpara ose gjatë momentit kritik të Regjistrimit (31 mars 2021, në ora 00:00), nuk duhet të regjistrohet, përkatësisht nuk duhet të grumbullohen të dhëna për te;

DUHET të regjistrohet:

c) Fëmijët të lindur në vet momentin kritik
d) Personat që ka vdekur pas momentit kritik, përkatësisht në periudhën prej më 01 prill të vitit 2021, deri në ardhjen e regjistruesit në ekonomi familjare së cilës ai person i ka takuar;

ç) Nëse ndonjë person ka lejeqëndrimi të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në kohëzgjatje prej 11 muaj dhe 29 ditë, në momentin kritik do të regjistrohet si person i pranishëm më pak se një vit.

7. KOHA (PERIUDHA) E REGJISTRIMIT

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të fillojë më 1 prill 2021 në ora 8.00 të mëngjesit, ndërsa do të mbarojë më 21 prill të vitit 2021, në ora 20.00.

Për personat jashtë vendit të cilët gjatë kohës (periudhës) së realizimit të Regjistrimit nuk do të gjenden në vend, do u mundësohet vetëregjistrimi në një aplikacion të veçantë që do të jetë në dispozicion në webfaqen e Entit shtetëror të statistikës, në periudhë prej 1 mars deri më 21 prill 2021.

8. REGJISTRIMI I KATEGORIVE TË VEÇANTË TË PERSONAVE

Për përmirësimin e përfshirjes dhe të cilësisë së të dhënave për kategoritë e caktuara të popullsisë, ESHS do të organizon regjistrim paraprak, edhe atë për:

1. **Personat që gjatë realizimit të Regjistrimit gjenden jashtë vendit**
   Mënyra e regjistrimit të këtyre personave është në përputhje me Metodologjinë që e sjell drejtori i Entit shtetëror të statistikës. Për këtë kategori të personave, në periudhë prej 01 deri më 21 prill 2021, ESHS do u mundësoj që të regjistrohen nëpërmjet një aplikacioni të dizajnuar të veçant, i cili do të jetë në disponim në webfaqen e ESHS-së. Kusht për vetëregjistrimin e kësaj kategorie të personave, si dhe anëtarët e familjeve/ekonomive familjare të tyre është numri amë i personave.

2. **Personat që gjatë kohës së Regjistrimit janë në shërbimin e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shtet ose jashtë vendit.**

   Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Entin shtetëror të statistikës e realizon regjistrimin e këtyre personave. Mënyra e regjistrimit të këtyre personave përcaktohet me udhëzimin që e miraton drejtori i Entit shtetëror të statistikës, në pajtim me ministrin e Mbrojtjes.

3. **Personat që në kohën e Regjistrimit gjenden në paraburgim ose në vuajtjen e dënimit me burg në burgjet, institucionet ndëshkuese – përmirësuese dhe shtëpitë edukativo – përmirësuese.**

   Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Entin shtetëror të statistikës e realizon regjistrimin e këtyre personave. Mënyra e regjistrimit të këtyre personave përcaktohet me udhëzimin të cilin e miraton drejtori i Entit shtetëror të statistikës, në pajtim me ministrin e Drejtësisë.

4. **Personat në shërbim në përfaqësitë diplomatiko – konzulare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtarët e familjeve të tyre që qëndrojnë bashkë me to.**

   Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me Entin shtetëror të statistikës e organizon regjistrimin e personave të cilët gjatë Regjistrimit janë me punë në përfaqësitë diplomatiko – konzulare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si edhe anëtarët e familjeve që përkohësisht qëndrojnë jashtë shtetit me personat e lartëpërmendur. Mënyra e regjistrimit të këtyre personave përcaktohet me udhëzimin që e miraton drejtori i Entit shtetëror të statistikës, në përputhje me ministrin e Punëve të Jashtme.

5. **Personat e pastrehë**

   Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në bashkëpunim me Entin shtetëror të statistikës e realizon regjistrimin e këtyre personave. Mënyra e regjistrimit të këtyre personave përcaktohet me udhëzimin që e miraton drejtori i Entit shtetëror të statistikës, në përputhje me ministrin e Punës dhe Politikës Sociale.

   Regjistrimi paraprak për personat të përmendur në pikat prej 2 deri 5, Regjistrimi zbatohet në periudhë prej datës 1 deri 15 mars 2021.

9. VENDI I REGJISTRIMIT

Me aplikimin e drejtë të konceptit të vendbanimit të zakonshëm, si një nga tiparet kryesore të personave - njësi të Regjistrimit, me çka u **mundësohet që çdo person të ketë një vendbanim të zakonshëm.** Kjo është me rëndësi edhe nga këndvështrimi kombëtar dhe ai ndërkombëtar, me qëllim që të evitohet që personat të përfshihen në popullsinë e përgjithshme të më shumë se një shteti ose të njejtit të mos përfshihen aspak.

Regjistrimi i personave - njësi të regjistrimit do të kryhet në vendin që do të gjenden.

Personat që gjatë kohës së Regjistrimit gjenden jashtë vendit do të regjistrohen në bazë të:

- Vetëregjistrimit nëpërmjet aplikacionit e cila është në dispozicion në webfaqen e ESHS-së. Kusht që të vetëregjistrohen është saktësia e numrit amë.
  dhe
- në bazë të numrit amë të personit që regjistrohet dhe numrit amë të personit që i jep të dhënat.

Të dhënat i jep person i rritur i familjeve të tyre që u janë më shumë të njohura.

Vendi i banimit është vendbanimi në të cilin personi është vendosur me qëllim të banimit të përhershëm.

Vendi i qëndrimit është vend i banuar ku personi qëndron përkohësisht, jashtë vendbanimit ku gjendet vendi i tij i banimit.

Vendbanimi zyrtar (legal) është vendi në të cilin personi është i regjistruar nga ministria kompetente dhe jeton në pajtim me rregullat e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vendi i banimit mund të jetë:

1. I njejtë ose i ndryshëm nga vendbanimi zyrtar (legal) i personit, ose
2. I njejtë ose i ndryshëm nga vendi i punës ose shkollës, ose
3. Mund të jetë i njejtë ose i ndryshëm nga vendi në të cilin personi gjendet gjatë kohës së Regjistrimit, ose
4. Një person mund të ketë dy a më shumë vende të banimit.

<u>VËREJTJE:</u>

Për kategori të caktuar të personave, me qëllim të zbatimit të drejtë të definicionit për vendbanim të zakonshëm, duhet të merret parasysh si në vijim:

- **për personat me vendbanim të zakonshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut,** regjistrimi bëhet në vendin ku personi **zakonisht banon**;
- **Për personat që do të gjenden në vendin e Regjistrimit për arsye pune**, ndërsa kanë ekonomi familjare/familje të tyre në vend tjetër brenda shtetit, vendi i tyre i zakonshëm është së bashku me ekonominë familjare/familjet e tyre.
- **Për nxënësit në arsim fillor dhe të mesëm që gjatë vitit shkollor** janë jashtë vendbanimit të zakonshëm të ekonomive familjare të tyre, duhet të regjistrohen në vendbanimin e zakonshëm së bashku me ekonomitë familjare, pavarësisht nga ajo se ku shkollohen fëmijët.
- **Për studentët të cilët shkollohen në vend,** vendbanimi i tyre i zakonshëm është së bashku me ekonomitë familjare të tyre, pavarësisht se ku studion në vend.
- **Për studentët të cilët shkollohen jashtë vendit, por jo në bazë të këmbimit ndërkombëtar të studentëve,** në përputhje me konceptin për vendbanimin e zakonshëm, vendbanimi i tyre i zakonshëm është shteti në të cilin studiojnë
- **Për personat të vendosur nëpër vendqëndrime kolektive për kujdes të përhershëm** (p.sh. shtëpi të pleqve, manastire,...), vendbanimi i tyre i zakonshëm është në vendqëndrim kolektiv.
- **Për personat-të huaj që kanë miratim për qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm** në Republikën e Maqedonisë së Veriut, regjistrimi kryhet në vendin e qëndrimit të lejuar.
- **Për të huajt me të drejtë të pranuar azili për shkak të mbrojtjes subsidiare, të huajt me kërkesë të parashtruar për pranimin e të drejtës për azil dhe status të pranuar refugjati** të cilët gjatë kohës së Regjistrimit do të gjenden në Republikën e Maqedonisë së Veriut, regjistrimi do të kryhet sipas vendit ku u është lejuar qëndrimi.
- **Për personat në punë ose qëndrim jashtë vendit**, të cilët do të vetëregjistrohen nëpërmjet aplikacionit të webfaqës së ESHS-së për Regjistrimin 2021, vendi i regjistrimit është adresa e fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rrespektivisht vendi i banimit zyrtar (legal) në Republikën e Maqedonisë së Veriut ku ka jetuar para se të largohen jashtë vendit.
- **Për personat me vendbanim të zakonshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët gjatë Regjistrimit gjenden jashtë vendit, ndërsa nuk janë vetëregjistruar nëpërmjet web-aplikacionit,** regjistrimi kryhet në vendbanimin e zakonshëm të tyre të fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëse në atë adresë ka ndonjë anëtarë të rritur të ekonomisë familjare apo person tjetër që mund t'i jep të gjitha të dhënat e nevojshme për këta persona. Të dhënat për këta persona sigurohen ekskluzivisht nga një anëtar i rritur i ekonomisë familjare ose një i rritur tjetër që i di më mirë të dhënat për ata persona. Ofruesi i të dhënave është i detyruar të bashkangjisë një dokument të përshtatshëm nga i cili mund të merret numri amë i personit që regjistrohet, si dhe një dokument përkatës nga i cili mund të

merret numri i tij personal i identifikimit (duke garantuar kështu saktësinë e të dhënave të ofruara).

- **Kur një person ka dy ose më shumë vende të banimit, personi do të regjistrohet** në atë vend në të cilin e kalon pjesën më të madhe të vitit, përkatësisht ai vend do të konsiderohet si vendbanimi i tij i zakonshëm. **Për shembull**, disa ekonomi familjare kanë shtëpi-banesë në qytet dhe në fshat. Periudhën e dimrit e kalojnë në qytet ndërsa periudhën verore në fshat. Ekonomia familjare do të regjistrohet në atë vend ku e kalon pjesën më të madhe të vitit. Shembull tjetër janë fëmijët të cilët pas divorcit të prindërve të tyre, mund ta zgjedhin për vendbanimin e tyre të zakonshëm ekonominë familjare në të cilën e kalojnë pjesën më të madhe të pushimit të tyre ditor, përkatësisht pushimit të natës.
- **Të pastrehët, nomadët, personat që bredhin, ose persona pa vendbanim të zakonshëm,** vendi i regjistrimit do të llogaritet njëkohësisht edhe si vendbanim i zakonshëm.

10. METODA E REGJISTRIMIT

Mbledhja e të dhënave në terren do ta bëjnë regjistruesit e autorizuar me intervistë "ballë për ballë" dhe me shënimin e të dhënave në formë elektronike - laptop.

Për çdo rreth të regjistrimit caktohet së paku nga një regjistrues, në varësi nga specifikat e rrethit të regjistrimit dhe nga struktura etnike e popullsisë.

Në regjistrimet e mëhershme të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, (të realizuara në territorin e sotshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut), përdorej metoda tradicionale e regjistrimit me intervistë nëpërmjet formularëve, Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2021, do të realizohet me zbatimin e të a.q. metoda e kombinuar regjistruese dhe qasje e re teknologjike me futjen e të dhënave regjistruese në kompjutor dore, laptop. Metoda e kombinuar e regjistrimit, është zgjidhje aplikative, ku është paraparë përdorimi i të dhënave nga baza e krijuar pararegjistruese (PR) e të dhënave, me të cilën nëpërmjet numrit amë të qytetarit, nga burimet e mëposhtme administrative, janë të integruar tipare të veçanta për njësitë e Regjistrimit.

Enti shtetëror i statistikës në përcaktimet e saja strategjike ka vendosur shfrytëzimin e burimeve administrative të të dhënave për qëllime statistikore si një nga prioritetet e saja.

Në proces të harmonizimit me sistemin statistikor evropian dhe duke ndjekur Kodin për punë të statistikës evropiane, përcaktimi strategjik i Entit shtetëtor të statistikës, krahas prodhimit të të dhënave nga hulumtimet statistikore, si burim sekondar është edhe shqyrtimi i mundësive për shfrytëzimin e burimeve administrative të të dhënave.

Zbatimi i metodës së kombinuar të regjistrimit imponon kushte dhe zgjidhje të caktuar të cilat janë të një rëndësie esenciale për rrumbullaksimin e plotë të procesit të përgatitjeve. Pra, metoda e kombinuar e regjistrimit bazohet në dy burime të dhënash, administrativ dhe në burimin nga terreni. Për dallim nga regjistrimi tradicional në terren dhe regjistrimit nga regjistrat, ku saktë është definuar burimi i vetëm i të dhënave, gjatë përdorimit të metodës së kombinuar përdoret dy burime të dhënash të cilët mund të plotësohen njëra me tjetrën apo të përdoren paralelisht.

Kombinimi i regjistrave dhe regjistrimi i plotë në terren mundëson mbulim të plotë gjeografik dhe detaizim konceptuale për tiparet të cilat grumbullohen, pavarësisht disponueshmërisë në regjistra ose jo. Mundësohet edhe një fleksibilitet maksimal në përmbajtjen e të dhënave të grumbulluara, ndërsa në të njëjtën kohë zvogëlohet detyrimi për përgjigje në krahasim me regjistrimin tradicional dhe mbledhjen e të njëjtave informacione.

Metoda e re e kombinuar regjistruese, (me zgjidhje aplikative) parasheh përdorimin e të dhënave nga baza e krijuar pararegjistruese me të cilën nëpërmjet numrin amë janë të integruar tipare të caktuara të personave - njësi të Regjistrimit, nga burimet e mëposhtme administrative dhe statistikore:

- **MPB** – Ministria e Punëve të Brendshme (baza e shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut)
- **MSHIA** – Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratë, (të dhëna të përfshira në Regjistër të popullsisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut);
- **APRMV** – Agjencia për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, (të dhëna rreth aktivitetit ekonomik të personave);
- **MASH** – Ministria për Arsim dhe Shkencë, (të dhënat për regjistrimin e nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme në vitit e ri shkollor);
- **DAP** – Drejtoria për të Hyra Publike, (të dhënat për personat të cilët kanë të ardhura dhe të cilët paguajn tatim mbi të ardhurat);
- **FSPI** – Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor, (të dhëna për shfrytëzuesit të sigurimit pensional dhe invalidor, domethënë përfituesve të pensioneve mbi gjitha bazat);
- **MPPS** – Ministria për Punë dhe Politikë Sociale (të dhënat për personat-shfrytëzuesit e të drejtës së transfereve sociale (të ardhurave) sipas të gjitha kategorive;
- **DULA** - Drejtoria për udhëheqjen e Librit amë, të dhëna nga libri amë për të lindurit, të vdekurit dhe personat e kurorëzuar
- **AKP** -Agjencia për kadastër të patundshmërive, të dhënave për patundshmëri dhe lëvizjet e tyre
- **ESHS** – Enti Shtetëror i Statistikës për të dhëna nga:

    - Hulumtime statistikor për studentë të regjistruar në studime diplomike (cikli i parë) nëpër fakultete dhe shkolla të larta profesionale në vitin akademik – VOI.20
    - Hulumtime statistikore për studentë të diplomuar në studime diplomike (cikli i parë) nëpër fakultete dhe shkolla të larta profesionale – VOI.50
    - Hulumtime statistikore për persona të cilët kanë marr titutllin magjistër ose specialist – VOI.80
    - Hulumtime statistikore për persona – doktor shkencash (të cilët kanë mbrojtur disertacionit e tyre) – VOI.70
    - Hulumtime statistikore për të lindurit VIT.1 dhe
    - Regjistri afarist statistikor.

10.1. BAZA PARAREGJISTRUESE (baza PR)

Baza pararegjistruese paraqet bazë për zbatimin e qasjes së kombinuar metodologjike për realizimin e Regjistrimit 2021. Për persona, ESHS ka siguruar të dhëna fillestare hyrëse, të siguruara nga burimet administrative dhe statistikore dhe nga të gjithë kualifikimet e nevojshme, lista të koduara dhe nomenklatura, si dhe dokumente në të cilën është siguruar informacioni për të gjithë modalitetet e përgjigjeve nga pyetjet të cilët shfrytëzohen gjatë grumbullimit të të dhënave në përputhje me instrumentet e definuara të regjistrimit. Hyn në sistem të dhënat nga burimet administrative para se të njejtat të shfrytëzohen për krijimin e tabelës me të dhëna për personat në bazën PR.

Shfrytëzohen burimet e të dhënave të përmendura në pjesën 10 nga kapitulli II. Janë të futura në sistem të gjithë listat koduese dhe klasifikimet të nevojshme për shpjegim dhe kontroll të mëtejshëm të të dhënave të cilat shfrytëzohen nga burimet administrative dhe statistikore. Baza PR

përmban të dhëna për persona - njësi të Regjistrimit, prej të cilëve në mënyrë automatike merren tipare të veçanta në zgjidhjen aplikative gjatë realizimit të Regjistrimit në terren. Në bazën PR ekzistojnë tiparet e mëposhtme për personat:

- Emri
- Mbiemri
- Mbiemri i vajzërisë
- Emri i babait
- Emri i nënës
- Numri amë
- Gjinia
- Statusi
- Shtetësia
- Adresa zyrtare e banimit
- Shteti i lindjes
- Vendbanimi i lindjes
- Shteti ku jeton
- Profesioni
- Vendndodhja e shkollës/fakultetit të cilën e ndjek
- Llojin dhe fushën e arsimit që ndjek
- Lloji dhe fusha e shkallës më të lartë të shkollës së kryer
- Numri amë, vendbanimi dhe veprimtaria e subjektit afarist ku personi punon
- Indikator për shfrytëzim të transfereve sociale – Indikator për shfrytëzues pensioni
- Indikator për fëmijët e lindur jashtë vendit dhe prindërit e tyre.

Krahas bazës Pararegjistruese, ESHS do të përdor edhe baza të tjera administrative në momentin e dhënë për verifikimin e saktësisë së të dhënave. ESHS, në fazën e përpunimit, gjatë konstatimit të ndonjë të dhëne të gabuar, bën koorrigjim në përputhje me bazën administrative të të dhënave.

Puna offline

Aplikacioni mundëson përdorimin e paraqitjes grafike dhe mënyrën e futjes së të dhënave adresore në situata kur nuk është krijuar një lidhje online me burimet e ESHS-së, përkatësisht në punë offline.

Kjo domethënë se regjistruesit, gjatë gjithë kohës së regjistrimit, u mundësohet funksionalitetet e aplikacionit. Të dhënat të cilët ruhen përkohësisht në laptop janë të kriptuara.

Zgjidhja aplikative mundëson paraqitje grafike (vizualizim GIS) në të cilën tregohen të dhënat hapësinore relevante për procesin e regjistrimit në terren (kufijt e komunës, vendbanimet, rrethet regjistruese, hyrjet e ndërtesave me numra të shtëpive, emrat e rrugëve, objektet për orientim, ortofotot). Regjistruesi do të përdor edhe skica të RRR në PDF format dhe pyetësor ndihmës, a.q. KONTROLLUES, në formë elektronike dhe të shtypur, ku do t'i shkruaj adresat në të cilat ka kryer

regjistrim, për një mbikqyrje dhe evidentim më të lehtë të njësive të regjistruara në rrethin regjistrues.

Regjistrimi realizohet në bazë të metodologjisë dhe udhëzimeve të njëllojta për punën e pjesëmarrësve në Regjistrim në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Krahas kësaj Metodologjie, shfrytëzohen edhe udhëzimet si në vijim:

- Udhëzim për mënyrën e regjistrimit të të gjithë pjesëmarrësve në Regjistrim;
- Udhëzim për vetëregjistrim nëpërmjet webaplikacionit për personat jashtë vendit;
- Udhëzim për mënyrën e regjistrimit të personave në shërbim të përfaqësive diplomatiko-konzulare (PDK);
- Udhëzim për mënyrën e regjistrimit në shtëpi ndëshkuese-përmisuese (SHNP);
- Udhëzim për mënyrën e regjistrimit të personave në shërbimin e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (ARMV) dhe
- Udhëzim për mënyrën e regjistrimit të personave të pastrehë.

11. PJESËMARRËSIT NË REALIZIMIN E REGJISTRIMIT

Regjistrimin e përgatit, organizon dhe realizon Enti shtetëror i statistikës.
Pjesëmarrësit në Regjistrim punojnë në bazë të autorizimit me shkrim ku të drejtën e inspektimit ka çdo person që regjistrohet, ndërsa Regjistrimin e kryejnë në përputhje me këtë Metodologji.
Të drejtat dhe detyrimet e tyre janë të përcaktuara në përputhje me Ligjin për Regjistrim të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2021 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.19/21)

11.1. TRUPA PROFESIONALE DHE PJESËMARRËSIT TJERË NË REALIZIMIN E REGJISTRIMIT

Në organizimin dhe realizimin e Regjistrimit marrin pjesë edhe:

- Këshilli për statistikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- komisionet për rajonet regjistruese,
- instruktorët shtetërorë,
- instruktorët rajonal,
- regjistruesit rajonal dhe

-pjesëmarrësit tjerë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Regjistrim të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2021

11.1.1. Këshilli për statistikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Ligjin për statistikë shtetërore, i jep mendim drejtorit të Entit shtetëror për statistikë për:

- përmbajtjen e Metodologjisë për Regjistrim dhe formularët regjistruese;
- masat organizativo-teknike për mbrojtjen e të dhënave nga Regjistrimi dhe
- programin për përpunimin dhe publikimin e të dhënave nga Regjistrimi.

Këshilli për statistikë, me kërkesë të drejtorit, merr qëndrime për çështje të caktuara metodologjike profesionale lidhur me realizimin e Regjistrimit.

Në punën e Këshillit, krahas kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të emëruar nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për çështjet lidhur me Regjistrimin, merr pjesë edhe zëvendësdrejtori i Entit shtetëror të statistikës.

11.1.2. Komisioni për rajon të regjistrimit kryen punët në vijim:

- Merr pjesë në informimin e popullatës për rëndësinë e Regjistrimit dhe për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në Regjistrim;

- Siguron kushte hapësinore dhe kushte të tjera materialo-teknike të nevojshme për realizimin e Regjistrimit;
- Ndërmerr masa për përfshirjen në kohë të njësive të Regjistrimit;
- Siguron kushte hapësinore dhe kushte të tjera të nevojshme për realizimin e trajnimeve të pjesëmarrësve në Regjistrim;
- Së bashku me instruktorët shtetëror realizon testimin e kandidatëve të paraqitur për Regjistrim;
- Së bashku me instruktorët shtetëror përgatisin propozim për zgjedhjen e instruktorëve dhe regjitruesve rajonal;
- Propozon shpërndarjen e regjistruesve dhe të instruktorëve rajonal në bashkëpunim me instruktorët shtetërorë dhe
- Kryen dhe punë të tjera lidhur me Regjistrimin, në pajtim me Udhëzimin për mënyrën e punës së komisioneve për rajonet e regjistrimit dhe Ligjin për regjistrim.

Komisioni i rajonit regjistrues është i përbërë nga 5 deri 11 anëtarë, duke përfshirë edhe kryetarin.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit për rajonin regjistrues përcaktohet varësisht prej numrit të komunave në rajonin regjistrues si dhe nga numri i përgjithshëm i popullsisë sipas Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2002.

Enti shtetëror i statistikës i emëron anëtarët e Komisionit nga rradhët e nëpunësve shtetëror, me propozim të njësive të vetëqeverisjes lokale të cilët e përbëjnë rajonin regjistrues.

Në Komisionin për rajonin regjistrues, sekretarët e komunave janë anëtarë sipas funksionit, si përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes lokale të cilët e përbëjnë rajonin regjistrues, si dhe nga një person profesional nga fusha e gjeodezisë nga secila komunë. Kryetari i Komisionit është sekretari i komunës ku gjendet edhe selia e rajonit regjistrues.

11.1.3. Instruktorët shtetëror i emëron drejtori i Entit shtetëror të statistikës nga rradhët e të punësuarve në Entin shtetëror të statistikës. Drejtori i Entit shtetëror të statistikës instruktorëve shtetëror u jep autorizim me shkrim.

Për çdo rajon regjistrues cakton nga një deri në pesë instruktorë shtetëror, nvarësisht nga numri i komunave në rajonin regjistrues dhe nga numri i përgjithshëm i popullsisë në rajonin regjistrues sipas Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2002.

Instruktorët shtetëror kryejnë punët e mëposhtme:
- Kujdesen që në mënyrë të drejtë t'i zbatojnë rregullat dhe udhëzimet metodologjike për realizimin e Regjistrimit;
- Marrin pjesë në përgatitjen dhe zbatojnë trajnimin e anëtarëve të komisioneve të rajoneve regjistruese, instruktorëve rajonal si dhe e mbikqyrin trajnimin e regjistruesve;
- Së bashku me Komisionin për rajonin regjistrues realizojnë testim të kandidatëve të paraqitur dhe përgatisin propozim për përzgjedhjen e instruktorëve dhe regjistruesve rajonal;
- Merr pjesë në organizimin dhe koordinimin e procesit të përgjithshëm të realizimit të Regjistrimit në rajonin regjistrues;
- Japin interpretime profesionale pjesëmarrësve në Regjistrimin për materialet metodologjike dhe për instrumentet tjera të Regjistrimit;
- I përcjellin qëndrimet e Entit shtetëror të statistikës për çështje të caktuara, i njoftojnë të gjithë pjesëmarrësit në Regjistrim dhe sigurojnë zbatim të tyre në terren;
- Rregullisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë e ndjekin realizimin e Regjistrimit dhe punën e instruktorëve dhe regjistruesve rajonal;
- Për çdo ditë e informojnë Entin shtetëror të statistikës për përgatitjen, rrjedhën dhe realizimin e Regjistrimit në terren dhe
- kryejnë punë të tjera dhe detyra pune që kanë të bëjnë me Regjistrimin, në përputhje me Ligjin.

Enti shtetëror i statistikës emëron instruktorët dhe regjistruesit rajonal pas konkursit publik dhe testimit paraprak të kandidatëve, nëse i plotësojnë kushtet e përgjithshme si në vijim:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të jenë të moshës madhore;
- të kenë të mbaruar së paku shkollën e mesme dhe
- të mos jenë në marrëdhënie pune.

Konkursi publik do të shpallet në selinë e rajonit regjistrues dhe në gazeta ditore, nga të cilat së paku në një gazetë që botohet në gjuhën maqedone dhe në gazetat që botohen në gjuhën që e flasin më së paku 20% e qytetarëve të vendit, ndërsa procedurën për testimin e kandidatëve të paraqitur e realizon Enti shtetëror i statistikës.

11.1.4. Instruktorët rajonal e realizojnë trajnimin e regjistruesve rajonal.

Instruktorët rajonal në mënyrë të drejtpërdrejtë e ndjekin regjistrimin e popullsisë që e kryejnë regjistruesit rajonal dhe kujdesen për regjistrim cilësor dhe përfshirje të plotë të njësive të Regjistrimit.

Instruktorët rajonal punojnë në pajtim me Udhëzimin për punë si dhe gjatë regjistrimit dhe në aktivitete tjera lidhur me Regjistrimin janë të obliguar të veprojnë në përputhje me instruksionet e instruktorëve shtetëror.

11.1.5. Regjistruesit rajonal bëjnë regjistrim të drejtpërdrejtë në terren dhe janë të obliguar që të fusin të dhëna në aplikacionin elektronik në përputhje me Udhëzimin për regjistrim.

Gjatë realizimit të Regjistrimit, regjistruesit rajonal marrin ndihmë profesionale dhe teknike prej instruktorëve rajonal dhe instruktorëve shtetëror.

Instruktorët shtetëror, rajonal dhe regjistruesit rajonal janë të obliguar që gjatë Regjistrimit të zbatojnë masa teknike dhe organizative për sigurimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave në përputhje me rregulloret në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

12. PËRDORIMI I GJUHËVE NË REGJISTRIM

Aplikacioni elektronik me të cilën kryhet regjistrimi funksionon në 7 (shtatë) gjuhë: gjuhë maqedone, shqipe, turke, rome, vllehe, serbe dhe boshnjake.

Regjistrimi do të kryhet në gjuhën që e zgjedh personi që regjistrohet ose personi i cili i jep të dhënat.

13. FUSHATA INFORMUESE DHE PLANI KOMUNIKUES PËR REGJISTRIMIN

Popullariteti i Regjistrimit, bëhet sipas strategjisë së përgatitur dhe planit komunikues për të gjitha aktivitetet që duhet të ndërmerren për promovimin sa më të mirë të Regjistrimit dhe kanalet për komunikim që përcjellin mesazhet kryesore lidhur me Regjistrimin.

14. MBROJTJA E TË DHËNAVE NGA REGJISTRIMI

Të dhënat personale të personave-njësi të Regjistrimit të cilat grumbullohen dhe përpunohen me Regjistrimin janë të dhëna konfidenciale dhe do të shfrytëzohet vetëm për qëllime statistikore në përputhje me Ligjin për statistikë shtetërore.

Të gjithë pjesëmarrësit në Regjistrim informohen për konfidencialitetin e të dhënave dhe në përputhje me të janë të obliguar të sigurojnë mbrojtjen e të dhënave, përndryshe përgjigjen në përputhje me ligjin.

15. PËRPUNIMI DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE NGA REGJISTRIMI

Përpunimin dhe publikimin e të dhënave nga Regjistrimi e realizon ESHS në përputhje me Programin për përpunimin dhe publikimin e të dhënave nga Regjistrimi. Publikimi i të dhënave prej Regjistrimit bëhet me akt për publikim.

III. TEKNOLOGJIA REGJISTRUESE

Ky kapitull i referohet teknologjisë së re të regjistrimit, që supozon zbatimin e qasjes së kombinuar metodologjike për realizimin e saj, dhe përdoret drejtëpërdrejtë, si për mbledhjen e të dhënave të regjistrimit, ashtu edhe për përpunimin dhe diseminimin e të dhënave nga regjistrimi.

Arkitektura e sistemit bazohet në qasjen e kombinuar metodologjike e cila përfshinë regjistrimin në terren duke përdorurur kompjutor-laptop për transfer nga ana e regjistruesve. Për këtë qëllim, në kompjuterët transferues, është instaluar një aplikacion i zhvilluar i veçant, karakteristikat e të cilit janë objekt i përshkrimit të kësaj Metodologjie. Regjistruesit, gjatë regjistrimit të personit-njësi të Regjistrimit, shkruan numrin amë të personit në interfejs të aplikacionit të instaluar në pajisjen trasferuese ku bëhet enkriptimi i të dhënave.

Logohet informacioni në lidhje me përdoruesin i cili ka filluar kërkimin. Aplikacioni lidhet me rrjetin 2G/3G/4G e cila duhet t'i kushtohet vetëm këtij qëllimi. I gjithë trafiku që lëshohet nga laptopi do të jetë enkriptuar gjatë tranzitit. Të dhënat dërgohen në aplikacionin Microsoft Azure dhe ruhen për aq kohë sa realizohet kërkimi. Aplikacioni Microsoft Azure lidhet me infrastrukturën e Entit shtetëror të statistikës nëpërmjet një lidhje enkriptive Site-to-Site VPN dhe transmeton informacionin në data-qendrën e Entit shtetërore të statistikës. Komponenta e instaluar lokale për integrim e shndërron kërkesën në formatin e duhur në përputhje me bazën lokale të të dhënave (Microsoft SQL Server 2017) dhe grupin fillestar të të dhënave për personin që është rezultat i kërkimit, kthehet në pajisjen transmetuese dhe në vazhdimësi plotësohen fushat përkatëse në interfejsin e aplikacionit për personin - njësi të Regjistrimit. E njëjta metodë zbatohet kur paraqiten të dhëna hapësinore relevante për rrethin e regjistrimit në të cilin kryhet regjistrimi. Fushat e mbetura janë subjekt i futjes së drejtpërdrejtë nga regjistruesi pas informacionit të siguruar nga personi i regjistruar.

Çdo transaksion që përfshin futjen, korrigjimin, fshirjen e të dhënave ose miratimin e tyre, regjistrohet në sistem, përkatësisht ruhet historiku dhe versionimi i secilës të dhënë të ndryshuar me informacionin për përdoruesin i cili ka bërë modifikimin (futjen, ndryshimin, fshirjen ose miratimin për një veprim të dhënë), koha në të cilën është bërë ndryshimi dhe arsyeja për të.

Foto.1 Arkitektura e sistemit



Tre karakteristika kryesore të sistemit, domethënë të aplikacionit, janë: automatizmi, integrimi dhe standardizimi.

- **Automatizimi** do të thotë që i gjithë procesi i punës është i automatizuar. Lidhja e burimeve koorporative brenda organizatës me cloud-shërbimet mund ta thjeshtoj dhe automatizoj procesin sa më shumë që të jetë e mundur. Përdorimi i të dhënave ekzistuese për personat - njësi të Regjistrimit, përdorimi i listave standarde të kodeve, klasifikimet dhe nomenklaturat, si dhe zbatimi i llojeve të ndryshme të validimit të të dhënave të mbledhura janë pjesë e qasjes së automatizuar në punë.
- **Integrimi** nënkupton fleksibilitet, përshtatje dhe skalabilitet të zgjidhjes. Integrimi, nga ana tjetër, nënkupton menaxhim të centralizuar me zgjidhjen, administrim qendror dhe automatik si dhe instalim të pajisjeve transmetuese vetëm për atë qëllim gjatë kyçjes në sistem si dhe menaxhim të centralizuar të burimeve koorporative në ESHS.
- **Standardizimi** domethënë përdorimi i standardeve atje ku është e mundur dhe pranimi i një sërë praktikave më të mira të standardizuara për ndërtimin e një zgjidhje të TI-së.

Sistemi përmban modulet si në vazhdim:

- Moduli për të dhëna adresore;
- Moduli për të dhëna për ndërtesë;
- Moduli për të dhëna për banesë;
- Moduli për listë të personave;
- Moduli për të dhëna të personave;
- Moduli për të dhëna për ekonominë familjare;
- Moduli për menaxhim me rregulla validimi;

IV. TIPARET PËR POPULLSINË QË REGJISTROHET

1. KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE

Një nga karakteristikat e rëndësishme të Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2021, është shkalla në të cilën mund të realizohet një klasifikim gjithëpërfshirës i njësive hapësinore, të përfshira me Regjistrim. Tiparet gjeografike që grumbullohen me Regjistrimin janë:

- **Lokacioni i vendmoshabanimit**
- **Fusha urbane dhe rurale**
- **Shkalla e urbanizimit**
- **Vendndodhja e vendit të punës dhe shkollës**

Zgjidhja aplikative mundëson paraqitje grafike në të cilën tregohen të dhëna hapësinore, relevante për procesin e regjistrimit në terren.

Pyetjet për njësitë hapësinore që grumbullohen me procesin e regjistrimit në terren janë të lidhura me:

- Kufijtë e komunave, vendbanimet, rrethi regjistrues, hyrjet e ndërtesave me numra të shtëpive;
- Adresa me emra të rrugëve;
- Vendbanimi, komuna dhe shteti i lindjes;
- Vendi i banimit (vendbanimi, komuna dhe shteti) i nënës kur është lindur personi;
- Për personat e ardhur, vendbanimi dhe komuna nga i/e cili/a personi është shpërngulur në vendin e banimit dhe viti i ardhjes, ndërsa për persona të ardhur nga jashtë vendit, viti i ardhjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

- Për personat të cilët punojnë ose ndjekin shkollimin jashtë vendin të banimit: emri i vendbanimit dhe komunës në të cilat personat punojnë ose ndjekin shkollimin dhe shpeshmëria e kthimit në vendin e banimit, si dhe
- Lloji i mjetit transportues me të cilin udhëtojnë deri te vendi i punës, rrespektivisht shkollimit dhe koha e harxhuar gjatë rrugës.

2. KARAKTERISTIKA DEMOGRAFIKE

2.1 Gjinia

Secili person njësi e Regjistrimit duhet të evidentohet në Regjistrim, sipas gjinisë mashkullore apo femërore. Gjinia, së bashku me moshën, janë tipare themelore demografike në Regjistrim të cilat më shpesh ndërthuren me tiparet e tjera të popullsisë. E dhëna për gjini të personit - njësi e Regjistrimit në mënyrë automatike gjenerohet nga baza PR, nga e dhëna për numrin amë.

2.2 Mosha

Mosha, si një nga tiparet kryesore demografike që grumbullohet me Regjistrim, i referohet viteve jetësore të personit – njësi të Regjistrimit.

E dhëna për moshën e personit – njësi të Regjistrimit në mënyrë automatike gjenerohet nga baza PR, nga e dhëna për numrin amë.

Në rast se personi-njësi e Regjistrimit nuk ka numër amë (i huaj i pranishëm në RMV, persona pa dokumente, të pastrehë, etj.), të dhënat e moshës gjenerohen nga të dhënat e datëlindjes. Prandaj, është thelbësore që të dhënat për moshën e personit të jenë sa më të plota dhe të sakta të jetë e mundur.

2.3 Statusi martesor (ligjor)

Martesa është bashkësi e rregullt mes një burri dhe një gruaje që rregullohet me ligj në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Statusi martesor përcaktohet si statusi martesor (ligjor) i secilit individ dhe shpesh quhet edhe si status de jure.

Pyetje: Statusi i juaj martesor (ligjor)

Përgjigja jepet sipas statusit martesor ligjor të personit, duke zgjedhur njërën nga përgjigjet e ofruara.

1. i/e pamartuar
2. i/e martuar
3. i/e ve
4. i/e divorcuar

Për personat që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore merret parasysh gjendja ligjore martesore për secilin prej tyre, pavarësisht nga kjo bashkësi.

Për personat më të ri se 18 vjet dhe për të gjitha personat të cilët asnjëherë nuk kanë qenë të martuar shkruhet i/e pamartuar.

2.4 Statusi martesor de facto

Statusi martesor de facto është bashkësi (martesore) joformale në jetën e gruas dhe burrit (partnerë) të cilët jetojnë në ekonomi familjare të njejtë dhe nuk janë në lidhje martesore, pavarësisht të gjendjes juridike martesore të partnerëve.

Pyetje: A jetoni në bashkësi jashtëmartesore?

Në këtë pyetje jepet përgjigje pa marrë parasysh statusin ligjor martesor të personit dhe moshën e personave. Për personat që jetojnë në një bashkësi jashtëmartesore, merret parasysh statusi ligjor martesor i secilit prej atyre personave, pavarësisht nga kjo bashkësi.

2.5 Numri i foshnjave të lindura të gjalla (duke përfshirë edhe ata që nuk janë gjallë)

Ky tipar i referohet personave të gjinisë femërore (në moshë prej 11 vjet e më shumë) dhe numrit të përgjithshëm të foshnjave të lindura të gjalla të cilët i ka lindur gruaja (përfshi këtu edhe fëmijët të cilët gjatë momentit të Regjistrimit nuk janë të gjallë).

Në numrin e foshnjave të lindura të gjalla nuk do të përfshihen: fëmijë të adoptuar, foshnjat e lindura të vdekura dhe fëmijët nga partneri nëse janë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore dhe të ngjajshme.

Pyetja parashtrohet pavarësisht gjendjes martesore të personit.

3. KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE

Pyetjet për aktivitetin ekonomik i referohet javës që i paraprinë Regjistrimit, përkatësisht javës prej 25 mars deri 1 prill 2021, para momentit kritik të Regjistrimit.

Në këto pyetje përgjigjen vetëm personat të moshës prej 15 vjet e më shumë.

3.1 Statusi në forcën e punës

Klasifikimi i personave sipas statusit në forcën e punës siguron informacion të rëndësishëm lidhur me qasjen e tyre në tregun e punës.

Personat klasifikohen në përputhje me statusin e tyre në forcën e punës në periudhën referues të:

- Popullatës së aftë për punë (forca e punës) të cilën e përbëjnë të gjithë personat të moshës prej 15 vjet e më tepër që punojnë ose kërkojnë punë me qëllim për të fituar për jetesë.
- Popullsinë ekonomikisht aktive e përbëjnë personat e punësuar dhe të papunësuar (forca e punës).
- Duke ndjekur edhe rekomandimet e ILO-së, te të punësuarit janë përfshirë persona në moshë prej 15 vjet e më shumë të cilët:
    - Gjatë javës së raportimit kanë punuar për të holla (para në dorë ose naturë) ose për fitim, më së paku 1 orë;
    - Gjatë javës së raportimit, përkohësisht kanë munguar në vendin e punës (domethënë për shkak të sëmundjes, mungesës, studimeve, ndërprerjes së aktiviteteve të subjektit afarist e kështu me rradhë), por formalisht kanë qenë të punësuar;
    - Kanë ndihmuar në pronën ose ndërmarrjen familjare pa pagesë.

Pyetje: A ka kryer javën e kaluar (më së paku një orë) çfarëdolloj aktiviteti për të holla ose lloj tjetër të kompensimit, përfshirë këtu edhe aktivitetin pa pagesë

Pyetjet për aktivitin ekonomik i referohen javës që i parapriu Regjistrimit. Në pyetjet që i referohen aktivitetit ekonomik, përgjigjen vetëm personat të moshës prej 15 vjet e më shumë.

3.2 Profesioni

Profesioni definohet si një grup detyrash dhe detyrave të punës të cilat në mënyrë organizative janë të përafërta dhe të lidhura, ndërsa për kryerjen e tyre kërkohet njohuri, aftësi dhe shkathtësi.

„Profesioni“ i referohet llojit të punës që kryhet në aktivitetin kryesor të punës të personit të punësuar, ndërsa nëpërmjet detyrave kryesore dhe obligimeve në vendin e punës, pavarësisht nga

veprimtaria ekonomike në të cilën është klasifikuar puna e personit apo në statusin e tij të punësimit.

Pyetje:Profesioni

Me qëllim që të fitojmë një përgjigje sa më të plotë nga kjo pyetje, duhet të shkruhet emri i saktë i punës së personit, pavarësisht shkollës dhe aftësimit profesional të tij. Duhet të theksohet se personi për këtë çështje përcaktohet sipas detyrave të zakonshme që ka kryer javën e fundit, ndërsa personi që ka munguar në punë gjatë javës së fundit përcaktohet sipas punëve dhe detyrave që zakonisht i kryen, rrespektivisht që do t'i kryej nëse do të ishte në punë. Nëse gjatë javës së fundit ka kryer disa lloje të punëve, përcaktohet sipas punës në të cilën ka kaluar pjesën më të madhe të orarit të punës. Përgjigja jepet me përzgjedhje nga Klasifikimi nacional i veprimtarive (KNV), i cili është përgatitur dhe harmonizuar në përputhje me parimet e Klasifikimit standard ndërkombëtar të veprimtarive ISCO-08.

3.3 Dega e aktivitetit ekonomik

„Sektori industrial" (degë e aktivitetit ekonomik) i referohet llojit të prodhimit apo aktivitetit të institucionit ose njësive të ngjajshme në të cilën është kryer puna kryesore e personit të punësuar.

Pyetje: Veprimtaria

Përgjigje jepet me përzgjedhje nga Klasifikimi i veprimtarive, KNV Rev.2, e integruar në aplikacion. Nëse prap nuk mund të gjendet veprimtari e caktuar në klasifikimin e bashkangjitur, përgjigja do të shkruhet tekstualisht. Nëse personi e ka shifrën e veprimtarisë kryesore, do të shkruhet shifra.

3.4 Statusi ekonomik

Klasifikimi i të punësuarve sipas statusit ekonomik bazohet në Klasifikimin ndërkombëtarë për statusin ekonomik të të punësuarve dhe thotë:

Pyetje: Statusi ekonomik i personit që punon

Përgjigje jepet me përzgjedhjen e njërës nga përgjigjet e ofruara:

1. I punësuar
2. Punëdhënës
3. I punësuar për llogari personale
4. Punëtor pa pagesë në biznesin e familjes
5. Tjetër

Gjithashtu, kjo pyetje i referohet javës së kaluar.

Përgjigja 1 – Të punësuar janë personat të cilët, sipas marrëveshjes formale, joformale ose vullnetare me punëdhënësin (vendor ose të huaj), punojnë në vend ose jashtë vendit, për kompensim si lloj page, provizion, me pagesë në të holla ose në naturë.

Kjo marrëveshje i referohet të gjithë personave të cilët gjatë kohës së Regjistrimit janë në marrëdhënie pune, rrespektivisht personave që kanë marrëveshje pune me punëdhënësin në kohë të caktuar ose të pacaktuar.

Në të njëjtën kohë, i referohet edhe personave që nuk kanë një marrëdhënie pune, ndërsa punojnë në bazë të llojeve të tjera të marrëveshjeve me punëdhënësin për kompensim në naturë ose në të holla, domethënë punë e padeklaruar (për shembull, një kamerier në një kafe bar, një shitës në një butik, një pastrues, etj.), gjithashtu, vlen edhe për njerëzit që janë në një marrëdhënie pune ose jo, ndërsa kryejnë punë si pastrues në ndërtesa, personat që kujdesen për fëmijët ose të moshuarit që kanë nevojë për kujdes, personat që përgatisin dru për ngrohje etj.

Punëtorët klasifikohen sipas veprimtarive ku e kryejnë punën e tyre, në përputhje me Klasifikimin nacional të veprimtarive, si dhe sipas profesioneve që kryejnë nëpër aktivitetin e tyre, dhe në përputhje me Klasifikimin nacional të veprimtarive.

Përgjigja 2 – punëdhënës - zgjedhet:

- për personat që menaxhojnë me ndërmarrje vetanake (që është i regjistruar si person juridik);
- për personat të cilët si pronar marrin pjesë në menaxhimin, rrespektivisht udhëheqjen e punëve të ndërmarrjes (e përzier, e përbashkët ose private) dhe duke punësuar një ose më tepër persona;
- për personat të cilët punojnë në shitore vetanake (artizanate, tregti, hotelieri ose lloj tjetër);
- për personat të cilët në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari si lloj profesioni (avokat, stomatolog, punëtor filmi, skulptor dhe të ngjajshme).

Tre kategoritë e para të përmendura mund të punësojnë një ose më shumë punëtorë.

Përgjigja 3 – i punësuar në llogari vetanake zgjedhet për personat të cilët kanë ndërmarrje vetanake ose në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari dhe nuk punësojnë persona tjerë.

Përgjigja 4 – punëtor i papaguar familjar zgjedhet për të gjithë personat të cilët punojnë pa pagë, në ndërmarrje, shitore ose në tokë bujqësore, pronë e ndonjë anëtari nga ekonomia familjare e tyre.

3.5 Burimi kryesor i mjeteve për jetesë

„ Burimi kryesor i mjeteve për jetesë " është burimi kryesor i të ardhurave nga i cili financohet konsumi personal i çdo personi gjatë një periudhe të caktuar referuese. Rekomandohet që përparësi t'i jepet periudhave më të gjata kohore, siç janë dymbëdhjetë muajt e mëparshëm, viti kalendarik ose financiar.

Informacioni mbi "burimin kryesor të mjeteve për jetesë " duhet t'u sigurohet të gjithë personave, pavarësisht nga statusi i tyre ekonomik dhe profesioni.

Të dhënat për personat të cilët shfrytëzojnë të ardhura nga marrëdhënia e rregullt e punës, pensione, transfere sociale, sigurohen edhe nga baza PR, nëpërmjet numrit amë.

<u>Pyetje: Burimet kryesore të mjeteve për jetesë një vit para Regjistrimit (mundet edhe dy përgjigje) dhe zbatohet klasifikimi në vijim:</u>

1. Pagë ose kompensim tjetër në bazë të punës së paguar
2. Të ardhura në bazë të prodhimeve/shërbimeve
3. Të ardhura në bazë të pronësisë apo investime tjera
4. Pensione
5. Transfere sociale
6. Borxhe
7. Burime tjera
8. Nuk ka të ardhura
9. Person i mbajtur

4. KARAKTERISTIKAT ARSIMORE

4.1 Shkalla më e lartë e arsimit të kryer është definuar si nivel më i lartë sipas Klasifikimit standard të arsimit sipas shkallëve (niveleve), (sipas ISCED 2013) të shkallës arsimore të kryer me sukses nga ana e personit. **Shkalla më e lartë e arsimit të kryer** zakonisht matet në lidhje me programin më të lartë të arsimit të përfunduar me sukses dhe që njëkohësisht vërtetohet nga një dokument i njohur kualifikimi.

Nëpërmjet këtij grupi të pyetjeve sigurohen edhe të dhëna për alfabetizëm (shkrim-lexim) dhe fushën për arsim.

<u>Pyetje: Shkalla më e lartë e arsimit të kryer (nuk përgjigjen personat të moshës ndër 10 vjet dhe personat të cilët akoma ndjekin shkollimin fillor)</u>

Përgjigje jepet duke përzgjedhur njërën nga përgjigjet e ofruara:

1 Pa shkollë
2 Shkollë fillore
3 Shkollë e mesme/gjimnazi
4 Arsimi pas të mesme por jo i lartë
5 Fakultet, shkollë e lartë, akademi
6 Magjistraturë
7 Doktorat

Me arsim të lartë të kryer nënkuptojmë llojin e shkollës me përfundimin e së cilës personi ka kryer nivelin më të lartë të arsimit. Prandaj, nuk duhet të bëhet dallimi nëse përgatitja shkollore është fituar duke përfunduar një shkollë të rregullt apo një shkollë që zëvendëson shkollën e rregullt (për shembull: shkolla për arsimin e të rriturve), rrespektivisht nëse është marrë duke marrë provime në një shkollë të rregullt apo nga përfundimi i një programi me shkollim të shkurtuar. Kurset që nuk japin një dëftesë për një shkollë të rregullt (për shembull: një kurs për daktilografistë, kontabilist, për gjuhë, etj.), nuk konsiderohen si përgjigje për këtë pyetje, por japin informacion në lidhje me nivelin shkollor të përfunduar më parë. Nëse personi ka ndjekur ose ka përfunduar një shkollë jashtë vendit, si përgjigje duhet të përmendet shkolla përkatëse në vend. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të shkruhet shkalla përkatëse e asaj shkolle, përkatësisht nëse është shkollë fillore apo e mesme, shkollë e lartë apo kolegj, fakultet, akademi.

5. MIGRIMI

5.1 Shteti i lindjes

Shteti i lindjes është shteti në të cilin ndodhet vendi i lindjes së një personi. Shteti i lindjes përdoret për të bërë dallimin midis banorëve të lindur në vend dhe atyre jashtë vendit. Duhet të theksohet se shteti i lindjes së një personi nuk është domosdoshmërisht e njëjtë me vendin e tij/saj të shtetësisë. Shteti i lindjes, gjithashtu, mund t'i referohet ose shtetit ku ka ndodhur lindja fizike ose shtetit në të cilin nëna zakonisht banonte në kohën e lindjes, nëse kjo është e ndryshme.

5.2 Shtetësia

„Shtetësia“ përkufizohet si lidhja e veçant juridike midis një individi dhe shtetit të tij/saj, të fituar me lindje ose natyralizim, qoftë me anë të deklaratës, të drejtës në përzgjedhje, martesës ose mënyrës tjetër, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Shtetësia përdoret për të indentifikuar popullsinë e përbërë nga shtetasit e huaj, e që janë ata persona që banojnë në vend, por që nuk posedojnë shtetësinë e atij vendi në të cilin kryhet Regjistrimi.

<u>Pyetje: Shtetësia (Pyetja vlen për të gjithë personat të cilët regjistrohen)</u>

Përgjigje jepet duke përzgjedhur njërën nga përgjigjet e ofruara:

1 Shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut

2 Shteta i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i një shteti tjetër

3 Shtetas i një shteti tjetër

4 Person pa shtetësi

5.3 Persona të cilët ndonjëherë kanë jetuar jashtë shtetit dhe viti i kthimit në vend

Ky tipat i referohet të gjithë personave që kanë jetuar ndonjëherë jashtë vendit aktual të vendbanimit të zakonshëm, pavarësisht nga shteti i lindjes ose shtetësisë, dhe pavarësisht nga ndryshimet e tjera të vendbanimit të zakonshëm që mund të kenë ndodhur brenda vendit. Për të mbledhur informacion mbi këtë temë, individët duhet të klasifikohen në varësi të faktit nëse ata kanë pasur ndonjëherë një qëndrim të zakonshëm jashtë vendit apo jo. Informacioni mbi këtë temë lejon identifikimin e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë. Për ata që kanë jetuar ndonjëherë jashtë vendit, duhet të mblidhen informacion edhe për vitin e mbërritjes në vendin aktual të banimit.

<u>Pyetje: Sa gjatë jeni prezent në adresën (vendin) e Regjistrimit</u>

Si përgjigje e kësaj pyetje regjistrohet koha e përgjithshme e qëndrimit të personit në vendin e Regjistrimit. Kohëzgjatja shkruhet në fushat e parapra për muaj dhe vite.

5.4 Vendi i lindjes

Vendi i lindjes është shumë i rëndësishëm për analizën e migrimeve të brendshme, por edhe të shpërnguljeve në vend. Vendi i lindjes mund të evidentohet sipas njësisë gjeografike ku ka ndodhur ose sipas vendbanimit të zakonshëm të nënës në kohën e lindjes. Disa shtete, siç ishte rasti edhe me vendin tonë, në regjistrimet e mëparshme, mblodhën informacione sipas të dy kritereve.
Në këtë Regjistrim, me "Vendi i lindjes" nënkuptojmë vendbanimin në të cilin nëna zakonisht jetonte në kohën e lindjes së personit-njësi e Regjistrimit. Për personat e lindur në vend, duhet të mblidhet informacione për njësinë më të vogël administrative (vendbanimin). Për personat e lindur jashtë vendit, mjafton të mbledhin informacione për shtetin e lindjes.

<u>Pyetje: Vendi i lindjes (vendi i banimit të nënës gjatë lindjes suaj)</u>

Nëse nëna e personit që regjistrohet ka jetuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut kur personi është lindur, shkruhet emri i tanishëm i vendbanimit dhe komunës në të cilën nëna ka jetuar gjatë kohës kur është lindur personi.

Nëse personi nuk e din emrin e komunës, duhet të përmendet ndonjë emër të ndonjë vendi të afërt (p.sh. Banja afër Koçanit etj).

Nëse personi ka lindur jashtë vendit, ndërsa nëna e tij ka jetuar ne Republikën e Maqedonisë së Veriut kur personi është lindur, shkruhet emri i vendbanimit dhe komunës në të cilën ka jetuar nëna në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Vendbanimi i mëparshëm dhe data e ardhjes në vendbanimin aktual

Ky tipar jep informacion mbi modelet gjeografike dhe kohore të levizjeve migruese drejtë vendit aktual të banimit.

<u>Pyetje: Prej nga dhe kur keni ardhur në këtë adresë (vendbanim) – shpërngulja e fundit</u>

Nëse personi - njësi i Regjistrimit jeton pandërprerë në adresën e Regjistrimit, rrespektivisht atje ka ardhur nga ndonjë adresë tjetër në vendbanim të njejtë apo të ndryshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rrespektivisht nga jashtë vendit, shkruhet vendbanimi dhe komuna në Republikën e Maqedonisë së Veriut prej nga ka imigruar personi (nëse personi më shumë herë është vendosur në të njejtën adresë, shkruhet vendbanimi i vendosjes së fundit), rrespektivisht e shtetit të huaj, nëse ardhja është nga jashtë shtetit.

6. KARAKTERISTIKAT ETNOKULTURORE

6.1 Përkatësia ndaj bashkësisë etnike

Përkatësia ndaj bashkësisë etnike definohet si ndjenjë e përkatësisë së personit - njësi të Regjistrimit ndaj bashkësisë së caktuar etnike. Kjo është njëra ndër çështjet më të ndjeshme të Regjistrimit dhe askush me asgjë nuk mund të ndikoj ndaj personit - njësi e Regjistrimit lidhur me përgjigjen në këtë pyetje.

<u>Pyetje: Përkatësia etnike</u>

Regjistruesi në këtë pyetje është i detyruar të shkruaj përgjigjen e personit i cili deklarohet për përkatësinë e tij ndaj bashkësisë etnike. Regjistruesi nuk duhet të lexojë përgjigjet e ofruara, por vetëm ta pyesë personin për përkatësinë e tij ndaj bashkësisë etnike. Nëse përkatësia etnike për të cilën personi është deklaruar nuk është në përgjigjet e ofruara, atëherë përgjigja duhet të shkruhet tekstualisht.

Personi mundet që për shkaqe teknike të mos përgjigjet lidhur me këtë pyetje. Në këtë rast, regjistruesi për këtë pyetje do ta zgjedh përgjigjen ''Nuk është deklaruar''.

Për fëmijë deri 15 vjet, përgjigje për këtë pyetje jep njëri nga prindërit, adoptuesit apo kujdestari.

6.2 Feja

Feja, zakonisht, konsiderohet si grup besimesh dhe praktikash që zakonisht përfshijnë njohjen e një hyjnie ose qenie të mbinatyrshme, një forcë ose parim, sipas së cilës njerëzit udhëheqin jetën e tyre në praktik dhe në kuptimin moral.

<u>Pyetje: Përkatësia fetare (religjioze)</u>

Në përputhje me nenin 19 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, qytetarëve u garantohet liria e besimit fetar, që do të thotë se qytetarët mund t'i shprehin lirshëm dhe publikisht besimin shpirtëror dhe fetar.

Personi që regjistrohet, sipas vullnetit të tij, mund të jap përgjigje, pavarësisht se a është i shënuar në librin e pjesëtarëve të ndonjë bashkësie fetare.

Në këtë pyetje, regjistruesi është i detyruar të shkruaj përgjigjen që deklarohet personi, domethënë regjistruesi nuk guxon të ndikoj ndaj qytetarëve që të deklarohen për përkatësinë fetare kundër vullnetit të tyre.

Regjistruesi gjithashtu është i detyruar ta shkruaj përgjigjen e kësaj pyetje me të cilën personi deklaron përkatisnë fetare. Regjistruesi nuk duhet t'i lexoj përgjigjet e ofruara, por vetëm e pyet personin për përkatësinë e tij fetare. Nëse përkatinë fetare që deklaron personi nuk gjendet në opcionet e ofruara, atëherë përgjigja duhet të shkruhet tekstualisht.

Për fëmijët deri 15 vjet, përgjigje në këtë pyetje jep njëri nga prindërit, adoptuesi apo kujdestari.

Personi mund që për shkaqe private të mos deklarohet lidhur me këtë pyetje. Në këtë rast, regjistruesi për këtë pyetje do ta zgjedh përgjigjen ''Nuk është deklaruar''.

Nëse personi deklaron se nuk është besimtar, nuk i takon asnjë besimi, atëherë shkruhet ''Nuk është besimtar'' apo ''Ateist''.

Nëse feja për të cilën është deklaruar personi nuk gjendet në opcionet e ofruara, atëherë përgjigja duhet të shkruhet tekstualisht.

6.3 Gjuha

Vendet shumëgjuhëshe dhe vendet me popullsi të konsiderueshme imigrantësh mund të mbledhin të dhëna për gjuhët që fliten dhe shkruhen, si një mënyrë shtesë për të matur identitetin kulturor dhe integrimin e tyre. Krahas kësaj, kur vendi ka më shumë se një gjuhë zyrtare, mund të

jetë e nevojshme të përfshihen pyetje mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në miratimin e ligjeve dhe politikave. Në varësi nga nevoja për të dhëna për përdorimin e një ose më shumë gjuhëve, rekomandohen konceptet e mëposhtme:

a) Gjuha amtare, e definuar si gjuha e parë që flitet nga fëmijëria e hershme në shtëpi;
b) Gjuha kryesore, e definuar si gjuha që personi e njeh më mirë;
ç) Gjuhë(a) e zakonshme, e definuar si gjuha që flitet më shpesh në shtëpi dhe/ose në punë;
d) Njohja e gjuhës (gjuhëve) definohet si aftësi që të flas/shkruaj në një apo më shumë gjuhë të ndryshme.

Pyetje: Gjuha amtare

Me gjuhë amtare nënkuptohet gjuha që personi e ka mësuar ta flas në fëmijërinë e hershme të tij, rrespektivisht gjuha që personi e konsideron si gjuhë të tij amtare, pavarësisht nëse ai ende e përdor atë gjuhë apo jo.

Nëse në shtëpinë e personit në fëmijërinë e tij të hershme janë folur më shumë gjuhë, si përgjigje do të shkruhet gjuha që më shpesh flitet në shtëpi.

Pyetje: Gjuha që zakonisht flitet në ekonomi familjare

Gjuhë e zakonshme është gjuha që personi çdo ditë ose më shpesh e flet në shtëpi. Nëse personi në shtëpi flet dy a më tepër gjuhë, si përgjigje shkruhet gjuha që më shpesh e përdor në komunikim të përditshëm.

Për fëmijët deri 15 vjet, përgjigje jep njëri nga prindërit, adoptuesi apo kujdestari. Për shurdhët, memecët, shurdhëmemecët dhe personat tjerë të cilët për arsye shëndetësore nuk janë në gjendje të flasin ndonjë gjuhë, shkruhet gjuha që më shpesh përdoret në ekonomi familjare.

Nëse gjuha për të cilën është deklaruar personi nuk gjendet në opcionet e ofruara, atëherë përgjigja duhet të shkruhet tekstualisht.

7. INVALIDITETI

7.1 Statusi i invaliditetit

Statusi i invaliditetit e karakterizon popullatën në persona me dhe pa aftësi të kufizuar. Personat me aftësi të kufizuara definohen si persona që janë në të ekspozuar në rrezik më të madh se popullata e përgjithshme, të cilët përballen me pengesa në kryerjen e detyrave të caktuara ose pjesëmarrjen në aktivitete që lidhen me rolet e tyre në shoqëri. Ky grup përfshin njerëz që përballen me kufizime në aktivitetet e tyre themelore funksionale, siç janë: ecja ose dëgjimi, edhe nëse kufizimet e tilla zvogëlohen duke përdorur mjete ndihmëse, mjedis mbështetës ose burime të shumta.

Te këta persona nuk është e patjetërsueshme të paraqiten kufizime në kryerjen e detyrave, siç janë: larja ose veshja ose pjesëmarrja në aktivitete tjera siç janë: puna apo shkuarja në shkollë, sepse janë bërë adaptime të nevojshëm për personin apo mjedisin. Sidoqoftë, këta persona do të konsiderohen të jenë të ekspozuar në rrezik më të madh të pengesave gjatë aktiviteteve sesa popullata e përgjithshme për shkak të pranisë së kufizimeve në aktivitetet e tyre kryesore funksionale dhe problemeve me mungesën e adaptimeve në mjedisin në të cilin ata jetojnë ose veprojnë.

Fatkeqësisht, sistemi shëndetësor dhe institucionet sociale nuk kanë të dhëna për të gjithë këto persona me pengesa të caktuara, dhe meqenëse Regjistrimi përfshin tërë popullsinë, të dhënat e mbledhura me këtë grup tiparesh do të sigurojnë një bazë të mirë për ndërtimin e politikave dhe

praktikave cilësore, me çka do të siguronin kushte për funksionimin sa më normal të personave me aftësi të kufizuara.

Pyetjet e invaliditetit nuk mblidhen për të përcaktuar statusin shëndetësor të personave, por për të parë se si vështirësitë që njerëzit ndjejnë, ndikojnë në kryerjen normale të aktiviteteve të përditshme, pra në rrjedhën normale të jetës së tyre shoqërore. Ky grup pyetjesh nuk përfshin të moshuarit që kanë vështirësi të caktuara në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, shkaku i moshës së tyre, si dhe nuk përfshinë personat me invaliditet të përkohshme, përkatësisht personat që kanë kufizime të përkohshme në kryerjen e aktiviteteve të përditshme.
Grupi i pyetjeve për personat me aftësi të kufizuara është në përputhje me rekomandimet e Grupit të Uashingtonit për pyetjet lidhur me vështirësitë me të cilat përballen këta njerëz.

Pyetje: A keni vështirësi për shkak të gjendjes tuaj shëndetësore (sëmundje, invaliditet) që ju pengojnë në kryerjen e aktiviteteve të përditshme?

Pyetje: Lloji i vështirësive

1. Me lëvizjen (ecjen, ngjitjen nëpër shkallë)
2. Me të pamurit (edhe pse mban syze)
3. Me dëgjimin (edhe pse mban aparat për dëgjim)
4. Komunikim
5. Vështirësi tjera

Te kjo pyetje përgjigje jepet për të pesë llojet e vështirësive shëndetësore me të cilat mund të përballet personi i regjistruar, si dhe për shkallën e ndikimit të situatës në kryerjen e aktiviteteve të përditshme të personit të regjistruar.

Pyetje: Cila është arsyja kryesore për vështirësitë e përmendura

Personi duhet ta përmend arsyen që përballet me vështirësitë e përmendura.

1. Sëmundje të lindur
2. Sëmundje kronike
3. Lëndim në punë
4. Sëmundje profesionale
5. Fatkeqësi komunikacioni
6. Tjetër

Pyetje: A përdor personi ndihmë nga persona tjetrë apo ndihmëse gjatë kryerjes së aktiviteteve të përditshme

Personi duhet të deklaroj nëse ai ka nevojë për ndihmë nga një person tjetër ose nga një ndihmëse në kryerjen e aktiviteteve të përditshme.

8. KARAKTERISTIKAT E EKONOMIVE FAMILJARE DHE FAMILJEVE

Ekonomia familjare, sipas praktikës sonë, është kategori ekonomike dhe definohet si grup i personave të cilët bashkëjetojnë në banesë të njejtë dhe bashkarisht i shpenzojnë të ardhurat e tyre. Ekonomitë familjare mund të jenë të vetme (vetëm një person) ose shumëanëtarëshe. Ata mund të jenë familjare (një a më tepër familje), jofamiljare (të përbëra nga persona të cilët nuk janë në lidhje familjare) ose e kombinuar (e përbërë nga persona të cilët formojnë familje dhe persona të cilët nuk janë anëtarë të familjes).

Familja, është kategori sociologjike dhe është e definuar me ligj. Familja mund të jetë e përbërë prej së paku dy personave (nuk ka familje njëanëtarëshe). „Familja“ është e definuar si bashkësi e dy e më tepër personave në një ekonomi familjare të njejtë dhe të cilët janë të lidhur nëpërmjet martesës, nga një lloj tjetër i regjistrimit ose bashkësi të kontraktuar (domethënë të pakurorëzuar) partnerë nga gjinia e kundërt ose gjinia e njejtë ose si prindë me fëmijë. Kështu,

familja përbëhet nga një çift me fëmijë ose çift me një e më shumë fëmijë, ose prind vetëushqyes me një e më tepër fëmijë. Te familjet me fëmijë, moment i rëndësishëm është që fëmijët asnjëherë të mos kenë qenë të martuar.

8.1 Lidhja mes anëtarëve të ekonomisë familjare

Të dhënat për lidhjet në ekonominë familjare grumbullohen vetëm për ekonomi familjare private (individuale). Për ekonomitë familjare kolektive nuk grumbullohet ky lloj i të dhënave. Lidhjet mes anëtarëve në ekonominë familjare private përcaktohen në bazë të lidhjes me një anëtarë të familjes, i cili fiton statusin e „Kryefamiljarit". Për të gjithë anëtarët tjerë të ekonomisë familjare përcaktohet lidhja ndaj atij personi, p.sh. bashkëshort/e, djal/vajzë, babai/nëna, familjarë tjetër, jo familjar etj.

Pyetje: Pozicioni në familje

01	Personi në emrin e të cilit udhëhiqet ekonomia familjare	07	Mbesë, nip
02	Bashkëshorte, bashkëshort	08	Reja, dhëndrri
03	Partnere, partner në bashkësi të pamartuar	09	Gjyshe, gjysh
04	Vajzë, djalë, fëmijë i adoptuar, pashtërk, i birësuar	10	Motër, vëlla
05	Nëna, babai	11	Familjarë të tjerë (daja-nusja e dajës, axha-nusja e axhës, tezja-burri i tezës, nipi nga vëllau/motra etj).
06	Vjehrri, vjehrra	12	Jo farefis
13 Nuk i përket ekonomisë familjare			

Shifra e lidhjes ndaj personit që udhëhiqet ekonomia familjare / personi referues

Pyetje: Numri i anëtarëve në ekonomi familjare

Shkruhet numri i përgjithshëm i personave të cilët e përbëjnë ekonominë familjare (në përputhje me definicionin për ekonomi familjare). Si anëtarë të ekonomive familjare mund të numërohen vetëm personat të cilët janë të përfshirë në kategorinë popullsi „e përgjithshme" ose „rezidente".

Pyetje: Pozicioni në familje

Nëse personi i cili duhet të regjistrohet i takon familjes (njërës prej familjeve) në ekonominë familjare, duhet të zgjidhet një nga shifrat për pozicionin në familje.

Shifrat për bashkëshortët /prindërit /partnerët		Shifrat për bashkëshortët /prindërit /partnerët		Sh
01	Bashkëshort në bashkësi martesore të kurorëzuar	07	Fëmijë i dy prindërve që janë në bashkësi martesore të kurorëzuar dhe të dy jetojnë në familjen e njëjtë	
02	Bashkëshorte në bashkësi martesore të kurorëzuar	08	Fëmijë i dy prindërve që janë në bashkësi të pakurorëzuar dhe të dy jetojnë në familjen e njëjtë	
03	Partner në bashkësi të pakurorëzuar	09	Fëmijë vetëm i bashkëshortit ose e partnerit të pakurorëzuar i cili jeton në familjen e njëjtë	
04	Partnere në bashkësi të pakurorëzuar	10	Fëmijë vetëm i bashkëshortes ose e partneres të pakurorëzuar e cila jeton në familjen e njëjtë	

Shifrat për bashkëshortët /prindërit /partnerët		Shifrat për bashkëshortët /prindërit /partnerët		Sh
05	Baba i vetëm me një fëmijë-më shumë fëmijë	11	Fëmijë i babait të vetmuar (pa bashkëshorte ose pa partnere në familje)	
06	Nënë e vetme me një fëmijë-më shumë fëmijë	12	Fëmijë i nënës së vetmuar (pa bashkëshort ose pa partner në familje)	
13 Nuk i takon familjes				

Shifra për gjendjen e personit në familje

8.2 Lloji i familjes

Në përputhje me definicionin për familje, dallojm keto lloje të familjeve:

- çift bashkëshortor pa fëmijë;
- çift bashkëshortor me fëmijë /fëmijë që nuk janë të martuar;
- prindër (partnerë që nuk janë të kurorëzuar) me fëmijë/fëmijë që nuk janë të martuar;
- nënë me fëmijë që asnjëherë nuk kanë qenë të martuar;
- baba me fëmijë që asnjëherë nuk kanë qenë të martuar.

8.3 Madhësia e familjes

Familjet duhet të klasifikohen sipas madhësisë në përputhje me numrin e përgjithshëm të anëtarëve të saj dhe numrit të përgjithshëm të fëmijëve që jetojnë në to.

8.4 Lloji i ekonomisë familjare individuale

Sipas llojit, ekonomi familjare private (individuale) mund të klasifikohet si familje e vetme apo shumëanëtarshe (me një a më tepër familje) ose ekonomi familjare shumëanëtarëshe jofamiljare.

8.5 Madhësia e ekonomisë familjare individuale

Ekonomitë individuale klasifikohen edhe sipas madhësisë, numrit të përgjithshëm të anëtarëve të ekonomisë familjare (njëanëtarëshe, dyanëtarëshe, treanëtarëshe etj.)

8.6 Baza e shfrytëzimit të banesës nga ana e ekonomisë familjare

Ky tipar i referohet dekretit me të cilën ekonomia familjare individuale zë tërë njësinë e banimit ose një pjesë të saj.

<u>Pyetje: Baza mbi të cilën ekonomia familjare e shfrytëzon banesën</u>

Përgjigje jepet me përzgjedhjen e njërës nga modalitetet e ofruar:

1 Banesë e banuar nga ana e pronarëve
2 Banesë e banuar nga bashkëpronarët
3 Banesë me qira
4 Tjetër

1. Banesë e banuar nga pronarët

Kjo përgjigje shkruhet në rast se një apo më tepër anëtarë të ekonomisë familjare është/janë pronar/ë i/të tërë banesës.

2. Banesë e banuar nga bashkëpronarët

Në rastet kur në një banesë jetojnë dy e më tepër ekonomi familjare dhe si bashkëpronarë

të banesës paraqitet anëtarët e dyjave (ose së paku dy ekonomive familjare), tek ekonomitë familjare në të cilën jetojnë bashkëpronarët, do të qëndrojë kjo përgjigje.

Nëse në banesë jetojnë më shumë ekonomi familjare dhe ka ekonomi familjare në të cilën nuk jeton personi i cili është pronar ose bashkëpronar i banesës, te këto ekonomi familjare nuk do të jepet kjo përgjigje, por do të zgjedhet modaliteti „Qiramarrës i banesës në pronësi private (të një pjese të banesës)“ ose modalitetin „Farefisëri“, varësisht të bazës në të cilën ajo ekonomi familjare e shfrytëzon banesën.

3. Banesë e dhënë me qira

Kjo përgjigje do të shkruhet në raste kur ekonomia familjare merr banesë me qira e cila është në pronësi private nga pushteti qendror apo lokal, në pronësi të përzier ose banesën e ka fituar nga bashkësia si banesë sociale.

4. Tjetër

Kjo përgjigje shkruhet për ekonomitë familjare që jetojnë në hapësira të llojeve tjera ose objekte të cilat nuk janë banesa në kupimin e definicionit për banesë, por të cilat gjatë regjistrimit shfrytëzohen për banim (hapësira tjera të banuara, hapësira afariste të banuara, vendqëndrime të improvizuara dhe koletive).

9. BUJQËSIA

Regjistrimi i fundit i ekonomive bujqësore ishte realizuar në vitin 2007 dhe imponohet nevoja që, sa më shpejtë që të jetë e mundur, edhe atë pas Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2021, vendi të realizoj një regjistrim të till. Regjistrimi në vitin 2021 do të shfrytëzohet që të grumbullohen të dhëna të caktuara për ekonomitë familjare të angazhuar në prodhimet bujqësore në llogari vetanake. Ky informacion është i nevojshëm që të mundësohet analizimi i mëtutjeshëm i Regjistrimit të popullsisë lidhur me bujqësinë dhe e njejta të përdoret si një kornizë për regjistrimin e ardhshëm të bujqësisë ose hulumtimeve anketuese lidhur me prodhimet bujqësore.

9.1 Prodhimi për llogari vetanake në bujqësi dhe karakteristikat e të gjitha aktiviteteve bujqësore gjatë vitit të kaluar

Pyetje: A punon ekonomia familjare tokën bujqësore (vetanake apo me qira)

Nvarësisht nga përgjigja e personit i cili i jep të dhënat për ekonominë familjare (në përputhje me drejtimet në Udhëzuesin) shkruhen përgjigjet : Po ose Jo.

Nëse përgjigja është „jo“ - mbarohet me pyetësorin për ekonomi familjare.

Nëse ekonomia familjare përgjigjet me „po“ - mëtej u përgjigjet pyetjeve të cilët i referohen llojit të tokës së punueshme.

Pyetje: Sa tokë punoni – në mënyrë të veçant shkruhet sipërfaqa e tokës së punueshme sipas kategorive, edhe atë:

1. Tokë e lërueshme dhe kopshte
2. Pemishte
3. Vreshta
4. Livadhe dhe kullosa
5. Kultivimi i këpurdhave

Regjistrohet sipërfaqa e përgjithshme e tokës së punueshme, pavarsisht asaj se ku gjendet, në territorin e komunës ku jeton ekonomia familjare apo në territor të komunës tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nëse në territorin ku realizohet Regjistrimi përdoren masa lokale për sipërfaqe, atëherë regjistruesi i përllogarit me ndihmën e tabelave për shndërrimin e masave lokale në hektar ose ari dhe i shënon në fushat përkatëse.

Pyetje: A disponon ekonomia familjare me bagëti, shpezë ose familje bletësh:

Regjistrohet bagëtia, shpezët dhe familje bletësh me të cilët disponon ekonomia familjare gjatë kohës së Regjistrimit.

Në zonat ku bagëtia gjatë stinës së pranverës dhe verës rregullisht nxjerrët për kullos ose çdo vit dërgohet në ekonomi tjera familjare për shkak kullosës, regjistrohet te pronari.

Modalitetet e ofruara për përgjigje:

1. **Gjedhë** (gjithsej) – Në gjedhë bëjnë pjesë të gjithë kategoritë të gjedheve, pavarësisht gjinisë, vjetërsisë dhe qëllimit të ruajtjes: viça, mëzet, lopë, shqerra barrsë, qe, buaj dhe krerë tjerë të rritur.
2. **Derra** (gjithsej) – Derrat janë të gjithë kategoritë e derrave, pavarësisht gjinisë, vjetërsisë dhe qëllimit të ruajtjes: derra, derrkuca, derrkuc për mbarsje, derr të patredhur dhe derra tjerë të rritur.
3. **Dhenë** (gjithsej) – Dhentë janë të gjithë kategoritë të dhenëve, pavarësisht gjinisë , vjetërsisë dhe qëllimit të ruajtjes: qengja, sheleg, dhenë për shumim, desh dhe dhenë tjerë të rritur
4. **Dhi** (gjithsej) – Shkruhet numri i të gjithë kategorive të dhive në përgjithësi, pavarësisht gjinisë, vjetërsisë, janë të reja, të rritura, krerë femrorë apo meshkullorë.
5. **Shpezë të rritur nga gjitha llojet (**gjithsej) – Shkruhet numri i përgjithshëm e shpezëve të rritur nga dyja gjinitë (pula, pata, rosa, miska). Nuk shkruhen shpezët të vjetër deri 1 muaj.
6. **Familje bletësh (**gjithsej) – Shkruhet numri i përgjithshëm i familjeve të bletave.

10. VENDQËNDRIMI, BANESAT DHE KUSHTET PËR BANIM

10.1 Lloji i vendqëndrimit

Lloji i vendqëndrimit i referohet banesave të banuara konvencionale, njësi tjera të banimit dhe vendqëndrimeve kolektive.

Me vendqëndrim nënkupton ata njësi për banim të cilët janë të banuara nga një ose më tepër persona. **Njësia për banim** definohet si vend i pavarur dhe i veçant i dedikuar ose jo për banim të një ekonomie familjare, por shfrytëzohet si vendbanim i zakonshëm për banim të një ekonomie familjare gjatë kohës së Regjistrimit.

Vendqëndrimet ndahen në:

1. Banesa konvencionale (të banuara, sezonale apo banesa të dyta ose banesa të pabanuara);
2. Njësi tjera banimi (ahër, garazh, magazin, çadër, vagon, jerevi etj.);
3. Vendqëndrime kolektive (hotel, shtëpi me dhoma që jepen me qira, institucione, kamp).

10.2 Kushtet për banim

Kushtet për banim u referohen tërë popullatës dhe llojit të banimit në të cilën personi zakonisht jeton gjatë kohës së regjistrimit. Kjo i përfshinë të gjithë personat të cilët gjatë kohës së Regjistrimit zakonisht jetojnë në lloje të ndryshme të vendqëndrimeve, duke përfshirë edhe personat e pastrehë.

Petje: Kushtet për banim
Kushtet për banim i referohen të gjithë popullatës dhe llojit të banimit në të cilën personi jeton zakonisht gjatë kohës së regjistrimit. Kjo i përfshinë të gjithë personat të cilët gjatë kohës së regjistrimit zakonisht jetojnë në lloje të ndryshme të vendit të jetesës, përfshirë edhe personat e pastrehë.

Përgjigje jepet me përzgjedhjen e njërës nga 4 modalitetet e mundshme:

1 Ekonomi familjare që jetojnë në banesë

2 Ekonomi familjare që jetojnë në njësi tjera të banimit (shtëpiza, kasollë, kolibe, rimorkio)

3 Ekonomi familjare kolektive

4 Të pastrehë, persona që nuk jetojnë në asnjë kategori të vendqëndrimeve.

Modaliteti 1 dhe 2 – Ekonomitë familjare të cilët jetojnë në banesë, rrespektivisht Ekonomitë familjare që jetojnë në njësi tjera banimi zgjedhet kur në banesë/vendqëndrim jeton ekonomi familjare në kuptimin e definicionit për ekonomi familjare.

Modaliteti 3 – Ekonomia familjare koletive zgjedhet si bashkësi e personave të cilët jetojnë në institucione të përkujdesit të përhershëm të fëmijëve dhe të rriturve, në manastire dhe spitale për akomodimin e të sëmurëve pa shërim.

Modaliteti 4 – Të pastrehë përdoret kur si njësi e regjistrimit përfshihen persona (individ) ose ekonomi familjare të cilët nuk kanë asnjë vendqëndrim.

Statusi i banimit të banesës konvencionale

Statusi i banimit tregon se a është banesa konvencionale vendbanim i zakonshëm për jetesë të një a më shumë personave. Banesa e cila e plotëson definicionin për banesë, mund të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme por, fillimisht duhet të jetë i dedikuar për banim.

Pyetje: Shfrytëzimi i banesës (statusi i banimit)

Përgjigje jepet duke zgjedhur njërën nga modalitetet e ofruara.

1. Banesa të banuara
   1.1. Vetëm për jetesë
   1.2. Për jetesë dhe kryerje të veprimtarive
2. Banesë e pabanuar (e zbrazët)
   2.1. Banesë e zbrazët
   2.2. Për kryerje të veprimtarisë
   2.3. Për pushim dhe rekreim
   2.4. Gjatë kohës së punëve bujqësore

Statusi i banimit i referohet asaj nëse banesa konvencionale gjatë kohës së Regjistrimit është e banuar apo jo. Për banesat e pabanuara (të zbrazëta ose për qëllim tjetër) përmendet arsyeja se pse nuk janë të banuara. Sa i përket statusit të banimit, janë propozuar përgjigjet në vijim:

1. Banesat e banuara konvencionale:

1.1. – vetëm për jetesë – rrethohet për banesë konvencionale të cilën e shfrytëzojnë një a më shumë ekonomi familjare gjatë tërë vitit;

1.2. – për jetesë dhe kryerje të veprimtarisë – rrethohet nëse në banesën që shfrytëzohet për banim kryhet edhe ndonjë veprimtari tjetër (rrobaqepsie, ondulimi, këpuctarie etj. ose jepen dhoma turistëve si lloj bujtine; apo në banesë është e vendosur zyrë avokati, atelie, ordinancë stomatologjike, përfaqësi të ndonjë subjekti afarist etj.).

2. Banesa të pabanuara konvencionale pa banorë gjatë kohës së Regjistrimit :

2.1. – banesë e zbrazët – rrethohet për banesë konvencionale e cila është e zbrazët për shkak se është e re dhe akoma e pa banuar (edhe pse në të është i lejuar banimi) ose është e zbrazur për shkak të shpërnguljes, adaptimit, riparimit dhe të ngjajshme, si dhe banesa tjera të zbrazëta dhe të pabanuara për arsye tjera (pronari i banesës jeton në banesë ose vend tjetër, kurse këtë banesë nuk e shfrytëzon as nuk e jep me qira; pronari i banesës është i ndjerë, ndërsa trashëguesit nuk e kanë dhënë banesën me qira as nuk e shfrytëzojnë përkohësisht, etj.) Këto banesa regjistrohen vetëm nëse janë në gjendje ndërtimore të rregullt ose me riparime të vogla që mund të aftësohen për shfrytëzim. Nuk duhet të regjistrohen banesat e braktisura në shtëpi të amortizuara dhe banesa të braktisura për arsye të vërshimit të vendbanimit, shembjes ose rrëshqitjes së dheut.

2.2. – për kryerje të veprimtarisë – rrethohet për banesë në të cilin askush nuk jeton, por tërësisht shfrytëzohet për kryerjen e ndonjë veprimtarie, edhe pse nuk është e riparuar (adaptuar) sa i përket anës ndërtimore në hapësirë pune, si dhe për banesat që kryesisht shfrytëzohen për dhënie me qira të turistëve.

2.3. – për pushim dhe rekreim (në vikend shtëpizë, shtëpi familjare ose lloj tjetër ndërtese) **–** rrethohet për banesë e cila shfrytëzohet kryesësisht për pushim dhe rekreim, qoftë përkohësisht, qoftë për më tepër muaj gjatë vitit. Banesa e këtillë mund të gjendet në shtëpi të veçant (vilë), në shtëpi familjare ose në një lloj tjetër ndërtese. Nëse banesa e dedikuar për pushim dhe rekreim, gjatë kohës së Regjistrimit plotësisht shfrytëzohet për banim, atëherë banesa regjistrohet si banesë „vetëm për banim".

2.4. – gjatë kohës së punëve bujqësore sezonale – rrethohet për banesa të cilët shfrytëzohen për qëndrim gjatë kohës së kryerjes së disa punëve bujqësore në vendbanimin ku gjendet ajo banesë.

Nëse vlerësoht se një banesë e caktuar mund të numërohet në njërën nga përgjigjet e kësaj pyetje, ndërsa gjatë kohës së Regjistrimit është i banuar si vendbanim i zakonshëm i ndonjë ekonomie familjare, atëherë ajo banesë do të regjistrohet si banesë konvencionale „vetëm për banim" (përgjigja 1 nga kjo pyetje).

Pyetje: Lloji i pronësisë

Kjo karakteristik i referohet llojit të pronësisë së banesave, por jo të tokës ku gjenden të njejtat.

Përgjigje jepet me përzgjedhjen e njërit nga modalitetet e ofruara:

1 Private
2 Shtetërore
3 E përzier
4 E panjohur

Modaliteti 1 – pronësia private zgjedhet për banesë e cila është në pronësi të qytetarit ose personit juridik (banesa në pronësi të kishës dhe personave tjerë juridik)

Modaliteti 2 – pronësi shtetërore zgjedhet për banesë e cila është në pronësi shtetërore ose në pronësi të njësive të vetqeverisjes lokale

Modaliteti 3 – pronësi e përzier zgjedhet për banesë e cila është në pronësi të shoqërisë akcionare, ndërmarrje e përzier ose shoqat

Modaliteti 4 – pronësi e panjohur zgjedhet kur personit që i jep të dhënat nuk e di përgjigjen.

10.3 Numri i banorëve në banesë

Numri i banorëve në banesë është numri i personave të cilëve banesa, rrespektivisht vendqëndrimi u është vendbanim i zakonshëm.

Pyetje: Numri i personave / anëtarë të ekonomisë familjare

Shkruhet numri i përgjithshëm i personave të cilët e përbëjnë ekonominë familjare (në përputhje me definicionin për ekonomi familjare).

10.4 Sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe/apo numri i dhomave të njësisë së banimit

Sipërfaqa e shfrytëzueshme është definuar si ''sipërfaqa e dyshemes e matur nga brenda mureve, përjashtuar bodrumet e pabanuara dhe tavanet dhe të gjithë hapësirat e përbashkëta të ndërtesave me më shumë banesa".

Pyetje: Sipërfaqa e përgjithshme e banesës (në m^2)

Në këtë pyetje jepet përgjigje duke shkruar sipërfaqen e përgjithshme të banesës.

Sipërfaqa e banesës paraqet përmbledhjen e sipërfaqeve të shfrytëzueshme në të gjithë hapësirat në banesë duke përfshirë edhe logjet (75% e sipërfaqes), terracat e mbulume (50% e sipërfaqes), ballkonët dhe terracat e hapura (25% nga sipërfaqa).

Në sipërfaqen e banesës përfshihen edhe dhomat të cilët në sqarimin për dhoma përmenden si hapësira të ndara nga banesa si tërësi.

Në hapësirën e banesës përfshihen edhe banjot dhe tualeti të cilët gjendet jashtë banese si tërësi ndërtimore edhe atë vetëm në raste të cilat këto hapësira nuk i ka në banesë edhe pse janë të pajisur me pajisje dhe instalim përkatës.

10.5 Dendësia standarde e banimit

Ky tipar nënkupton sipërfaqen e banesës, rrespektivisht vendinqëndrimin (e shprehur në m^2) sipas personit, banor i banesës. Realizohet si ndarje nga e dhëna për sipërfaqen e banesës dhe nga e dhëna për numrin e banorëve në banesë.

Pyetje: Numri i përgjithshëm i dhomave (me sipërfaqe më e madhe se 6 m^2)

Përgjigje jepet me shënimin e numrit të përgjithshëm të dhomave të cilët janë me sipërfaqe të dyshemes më shumë se 6 m^2.

Definicioni për dhomë

Dhoma është njësi hapësinore e një banese e dedikuar për banim dhe e cila është e ndarë nga hapësirat tjera të banesës me mure ekzistuese, ka dritë ditore të drejtëpërdrejtë, ndërsa sipërfaqa e dyshemesë është së paku 6 m^2. Me nocionin dritë ditore të drejtëpërdrejtë nënkuptohet drita që depërton nëpërmjet dritareve të vet hapësirës, ndërsa vjen nga vend i hapur: nga rruga, oborri, terraca ose baxho.

Dhomat më të vogla se 6m^2 nuk paraqiten në numrin e përgjithshëm të dhomave, por katrorët e saj numërohet në katrorët e përgjithshëm të banesës.

Në numrin e dhomave përfshihen edhe dhoma që është e ndarë nga hapësirat kryesore të banesës.

Kuzhina, nëse ekziston si hapësirë e veçant e banesës, përjashtohet nga numri i dhomave.

10.6 Sistemi i furnizimit me ujë

Është e nevojshme të mbledhen informacion për sistemin kryesor të furnizimit me ujë për të gjithë llojet e njësisë së banimit, por veçanarisht për sistemin për furnizim me ujë për banesat e banuara konvencionale.

Pyetje: Mënyra me të cilën ekonomia familjare furnizohet me ujë për pije

Nëse ekonomia familjare shfrytëzon më shumë mënyra për furnizim me ujë për pije, atëherë si përgjigje përmendet mënyra e cila përdoret më shumë.

Kur ekonomia familjare furnizohet me ujë për pije në mënyrë të përmendur nën shifrën 01 dhe 02, përparësi i jepet përgjigjes me shifrën 01.

Nëse përgjigjet 01 dhe 02 paraqiten në kombinim me përgjigje tjetër, atëherë përparësi i jepet përgjigjes 01 ose 02.

Në raste kur më shumë ekonomi familjare furnizohen me ujë për pije nga i njejti bunar, burim, çezëm rrugore ose të ngjajshme, atëherë për çdo shënim nga çdo ekonomi familjare veçmas jepet e njejta përgjigje.

Mënyra e furnizimit me ujë:

01 Ujë në banesë me lidhje në ujësjellës publik
02 Ujë në banesë me lidhje në hidrofor personal
03 Çezmë në oborr me lidhje në ujësjellës publik
04 Çezmë rrugore me ujë prej ujësjellësi publik
05 Çezmë rrugore me ujë prej burimi të posaçëm
06 Pus klasik (pus i ndërtuar me mur prej guri, tjegulla ose të veshur me një shtresë prej gline me trashësi 30cm, përkatësisht e ndërtuar me unaza betoni)
07 Pus i shpuar (me gypa)
08 Autobot (rezervoar me ujë) me filter
09 Autobot (rezervoar me ujë) pa filter
10 Ujë në shishe/e flashuar

10.7 Pajisje me tualet

Është e nevojshme të mbledhen informacione për pajisje me tualet për të gjithë llojet e njësive të banimit, posaçarisht për pajisjen me tualet të banesave të banuara konvencionale.

Pyetje: Tualet

Përgjigje jepet duke përzgjedhur njërin nga modalitetet e ofruara:

1 Ka
2 Ka, jashtë banese
3 Nuk ka

Tualeti është një nga hapësirat ndihmëse në banesë i cili duhet të pajiset me guacë për nevojtore, me kazan për shpërlarje dhe lavaman (nëse shërben edhe si banjo, atëherë duhet të përmbaj edhe elemente tjera të përmendura në modalitetin ,,Banjo"), instalime për kanalizim dhe ujësjellës, pavarësisht se a janë të lidhura me ndonjë nga kyçjet për sjelljen dhe përçimin e ujit.

Me **modalitetin 1** përgjigjet kur banesa si tërësi ndërtimore posedon tualet si hapësirë ndihmëse.

Me **modalitetin 2** përgjigjet kur banesa si tërësi ndërtimore nuk posedon tualet, por ai gjendet jashtë banese (nëse ekziston tualet edhe në banesë edhe jashtë banese, atëherë si përgjigje do të merret modaliteti 1).

Me **modalitetin 3** jepet përgjigje kur banesa nuk ka tualet as në përbërjen e saj as jashtë përmbajtjes së tërësisë banesore.

10.8 Pajisja me banjo

Është e nevojshme të mbledhen informacione për pajisjen me banjo për të gjithë llojet e njësive të banimit, posaçarisht për pajisjen me banjo të banesave të banuara konvencionale.

Pyetje: Banjo

Përgjigje jepet duke përzgjedhur njërin nga modalitetet e ofruara:

1 Ka
2 Ka, jashtë banese
3 Nuk ka

Banjoja është njëra nga hapësirat ndihmëse në banesë e cila duhet të jetë e pajisur me vaskë ose dush-vaskë (nëse shërben edhe si tualet, atëherë duhet t'i përmbaj edhe elementet tjera të përmendura në modalitetin „Tualet"), instalime për ujësjellës dhe kanalizim, pa marrë parasysh se a janë të lidhura me ndonjë nga kyçjet për sjelljen dhe përçimin e ujit.

Me **modalitetin 1** përgjigjet kur banesa si tërësi ndërtimore posedon banjo si hapësirë ndihmëse.

Me **modalitetin 2** përgjigjet kur banesa si tërësi ndërtimore nuk posedon banjo, por ai gjendet jashtë banese (nëse ekziston banjo edhe në banesë edhe jashtë banese, atëherë si përgjigje do të merret modaliteti 1).

Me **modalitetin 3** jepet përgjigje kur banesa nuk ka banjo as në përbërjen e saj as jashtë përmbajtjes së tërësisë banesore.

10.9 Mënyra e ngrohjes

Është e nevojshme të mbledhen informacione për mënyrën e ngrohjes së banesave të banuara konvencionale dhe njësive tjera për banim.

<u>Pyetje: Mënyra e ngrohjes së ekonomisë familjare</u>

Përgjigje jepet duke zgjedhur njërën nga modalitetet e ofruara.

Mënyra e ngrohjes së ekonomisë familjare

1. Ngrohje qendrore nëpërmjet rrjetit publik
2. Ngrohja qendrore me instalim vetiak
   - 2.1. Me energji elektrike
   - 2.2. Me dru
   - 2.3. Me qymyr
   - 2.4. Me peleti
   - 2.5. Me naftë
   - 2.6. Me karburantë gazi
   - 2.7. Lloje tjera karburanti për ngrohje të papërmendura
3. Ngrohje me stufë
   - 3.1. Me energji elektrike
   - 3.2. Me dru
   - 3.3. Me qymyr
   - 3.4. Me peleti
   - 3.5. Me naftë
   - 3.6. Me karburantë gazi
   - 3.7. Lloje tjera karburanti për ngrohje të papërmendura
4. Kondicioner
5. Lloje tjera të papërmendura të karburantëve (diellor, gjeotermal etj)
6. Pa ngrohje

Kjo pyetje i referohet mënyrës se si çdo ekonomi familjare ka ngrohë banesën, rrespektivisht në llojin e materialit për ngrohje i cili është përdorur gjatë sezonës së fundit të ngrohjes.

Pyetja përbën tre grupe kryesore të modaliteteve, edhe atë:

1. Ngrohje qendrore

Ky modalitet nënkupton se banesa (ose një pjesë e saj) ngrohet nga ngrohtorja e qytetit ose asaj rajonale nëpërmjet rrjetit shpërndarës të qytetit apo asaj rajonal, me instalime për ngrohje qendrore.

2. Ngrohje qendrore me instalim vetanak

Ky grup i modaliteteve nënkupton se banesa (ose një pjesë e saj) ngrohet nëpërmjet instalimit vetanak të ngrohjes e cila nuk është e lidhur në rrjetin qendror shpërndarës, por nga kazani i instaluar privat për ngrohje të energjisë elektrike, me karburante të forta, të lëngshme ose prej gazi dhe e cila mund të ngrohë një a më shumë banesa.

3. Ngrohja me stufë

Ky grup i modaliteteve nënkupton se banesa (ose një pjesë e saj) ngrohet me një ose më shumë stufa të cilët si energjencë përdorin energjinë elektrike, karburantë të fortë, të lëngshëm ose me gaz. Me termin stufë e energjisë elektrike nënkuptojmë edhe trupa të ndryshëm për ngrohje (ngrohje në formën e radiatorëve, paneleve dhe të ngjajshme) dhe kondicioner (të thjeshtë ose inverter), të cilat si energjencë shfrytëzojnë energji elektrike.

Ekonomia familjare mund ta ngrohë banesën (ose një pjesë të banesës) duke shfrytëzuar kombinimin e më shumë modaliteteve të dhëna. Në këtë rast zgjedhet modaliteti i cili përdoret më shumë ose më shpesh me të cilën ngrohet hapësira më e madhe e banesës.

4. Lloj tjetër i ngrohjes

Ky modalitet zakonisht evidentohet te vendqëndrimi i improvizuar i cili, përveç që mund të ngrohet me stufë, mund të ngrohej edhe me oxhak të improvizuar ose më ndryshe nga mundësitë e lartëpërmendura.

10.10 Banesa sipas llojit të ndërtesës

Ndërtesë konsiderohet çdo objekt ndërtimor që ka pullaz dhe katër mure të pavarura që shtrihen prej tokës deri në pullaz, dhe që ka një apo më tepër hyrje (me një apo më tepër numra shtëpie), ndërsa është e ndërtuar që të jetohet në të, të kryhet ndonjë veprimtari ose të ruhen të mirat materiale.

Banesat mund të klasifikohen edhe sipas llojit të ndërtesës në të cilën gjenden. Ndërtesa e cila përmban banesa konvencionale është njësi e rëndësishme indirekte sepse karakteristikat e ndërtesës, p.sh. lloji i ndërtesës dhe periudha e ndërtimit e kështu me rradhë, janë të rëndësishme për karakteristikat e banesave në vet ndërtesën.

<u>Pyetje: Lloji i vendqëndrimit</u>

Përgjigje jepet duke përzgjedhur njërin nga modalitetet e ofruara:

- **<u>Ndërtesa banesore</u>** është ndërtesa e cila ka një a më shumë banesa dhe numër të përbashkët të shtëpisë, në të cilën 50% apo më shumë nga sipërfaqa e saj e përgjithshme është e dedikuar për qëllime banesore, rrespektivisht për banim. Ndërtesë banesore është edhe ndërtesa e cila ka hapësira afariste dhe hapësira tjera jobanesore, ndërsa banesat përfshinë sipërfaqe më të mëdha të ndërtesës.
- **<u>Ndërtesa jobanesore</u>** është ndërtesa në të cilën nuk ka banesa konvencionale ose në të cilat më pak se 50% nga sipërfaqa e saj e përgjithshme është dedikuar për qëllime banesore, rrespektivisht për banim.
- **<u>Ndërtesa për banim kolektiv</u>** është objekti që është projektuar për banim të një grupe më të madhe personash ose disa ekonomi familjare dhe e cila shfrytëzohet si vendbanim i zakonshëm, minimum nga një person gjatë kohës së Regjistrimit.

  Kjo kategori i përfshinë hotelet, bungalët, kampet dhe institucionet për akomodim të përhershëm të personave të cilat i shfrytëzojnë hapësirat e përbashkëta siç janë kuzhina, banjot, dhomat e fjetjes etj; pastaj i përfshinë spitalet, senatoriumet dhe shtëpitë për rehabilitim, shëpitë studentore, manastiret, burgjet, baraket policore apo ushtarake dhe shtëpitë përmirësuese.

Hapësirë tjetër e banuar është përgjigja nëse ndërtesa nuk bën pjesë në asnjë nga tre modalitetet e ofruara.

10.11 Katet e ndërtesës

Katet e ndërtesës konsiderohen nga kati i parë e më lartë (duke përfshi edhe katin e parë), ndërsa kati përdhesë, mezanini, bodrumi, qilari dhe mansarda (nënkulmi) nuk konsiderohen për kate të ndërtesës, rrespektivisht nuk numërohet në katet e ndërtesës.
Rekomandohet zbatimi i klasifikimit në vijim për numrin e kateve në ndërtesë:

(1.0) 1 katëshe
(2.0) 2 katëshe
(3.0) 3 katëshe
(4.0) 4 katëshe
(5.0) 5-9 katëshe
(6.0) 10-19 katëshe
(7.0) 20 katëshe e më tepër.

10.12 Banesat sipas periudhës së ndërtimit

Periudha e ndërtimit matet sipas datës kur ndërtesa ka përfunduar.

Pyetje: Viti i ndërtimit të ndërtesës

Si e dhënë për vitin e ndërtimit të ndërtesës merret viti kur ndërtesa është ndërtuar, rrespektivisht kur ka përfunduar, ndërsa për objektet të cilët janë sanuar ose kanë pësuar ndryshime më të mëdha shkruhet viti kur kanë përfunduar aktivitetet ndërtimore.

Nëse në një ndërtesë banesat janë ndërtuar, mbindërtuar ose rikonstruar në periudha të ndryshme, atëherë kjo e dhënë do të jetë e ndryshme për çdo banesë veçmas.

Për banesë të përfunduar e cila gjendet në ndërtesën e papërfunduar, shkruhet viti i përfundimit të ndërtimit të asaj banese.

Nëse në ndërtesë është kryer sanim ose adaptim, duhet të përmendet periudha kur është e ndërtuar ndërtesa kryesore, por nëse janë bërë rekonstruime më të mëdha me të cilin ndryshohet sistemi konstruktiv i ndërtesës, atëherë duhet të përmendet periudha e rekonstruimit.

10.13 Materiali me të cilin është ndërtuar sistemi mbajtës i ndërtesës

Në këtë pyetje jepet përgjigje vetëm për materialin që kryesisht është përdorur gjatë ndërtimit të sistemit mbajtës të ndërtesës.

Sistemi mbajtës i ndërtesës në fakt është element/e të një ndërtese të cilat mund të jenë të ndryshme, rrespektivisht ndërtesa mund të ketë mure mbajtës (të tërthortë, të vazhdueshëm ose vetëm mure mbajtës të jashtëm), të ketë sistem konstruktiv (trarë dhe shtylla) dhe konstrukcion kornizë ose lloj tjetër të konstrukcionit mbajtës.

Materiali prej të cilit është ndërtuar sistemi mbajtës i një ndërtese mund të jetë nga më të ndryshëm, por materialet ndërtimore të përmendura në modalitetet prej 1 deri 6 konsiderohen për materiale ndërtimore të forta, ndërsa materialet ndërtimore të përmendura në modalitetin 7 (qerpiç, plithar, baltë e fortë, dërrasa etj) konsiderohen për materiale të dobëta ndërtimore dhe shpesh paraqitet te ndërtesat më të vjetra.

Betoni dhe betoni i armuar dhe çeliku (konstrukcioni kornizë dhe skeletor) është sistem ndërtimi ku ngarkesa e tërë ndërtesës në terren transferohet nëpërmjet trarëve të armuar dhe shtyllave dhe kjo përgjigje do të evidentohet në të gjitha ndërtesat e mëdha banesore, ndërsa në ndërtesat individuale të banimit, pronari do të pyetet për sistemin mbajtës të ndërtesës, edhepse zakonisht ndërtesat më të reja (pas vitit 1990) rregullisht janë ndërtuar me konstrukcion skeletor.

Zakonisht, sistemi masiv i ndërtimit, ku ngarkesa e tërë ndërtesës në terren transferohet nëpërmjet mureve, mund të jetë nga: blloqet e betonit, tulla, gurë dhe panele druri të parafabrikuara (materiale të forta ndërtimore).

Përgjigje jepet duke përzgjedhur njërën nga modalitetet e ofruara.

1. Beton dhe beton të përforcuar
2. Çelik
3. Blloqe betoni
4. Tjegulla
5. Guri
6. Montimi i paneleve prej druri
7. Materiali i dobët ndërtimor

10.14 A posedon ndërtesa fasadë efikase energjetike

1. Po
2. Jo

10.15 A posedon ndërtesa ashensor

Rekomandohet të mblidhni informacione në lidhje me disponueshmërinë e ashensorit që është në përdorim / funksionim në ndërtesat shumëkatëshe. Informacioni nuk duhet të kufizohet vetëm në praninë e një ashensori, por gjithashtu, nëse ai ashensor është në funksion shumicën e kohës dhe nëse mirëmbahet rregullisht.

10.16 A posedon ndërtesa qasje për personat me nevoja të veçanta

Kjo karakteristik i referohet mënyrës së qasjes së banorëve në ndërtesë ose banesë, veçanarisht qasjen nga personat me invaliditet.

V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo Metodologji hyn në fuqi të nesërmen pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 23-4/1
4 shkurt 2021
Shkup

Drejtor
Apostol Simovski